



PROBLEME AKTUALE TË MOSHËS SË TRETË NË SHQIPËRI

*(Gjetje të Vrojimit të MPÇSSHb në funksion të përgatitjes
së Dokumentit Strategjik Ndërsektorial të Moshimit, 2009-2013)*

AUTORËT

ZNI. ANNA XHEKA
ZNI. VALBONA JAUPLLARI
Z. ZEF PREÇI

Botuar nga "ExpoVizion"

Ky botim u mundësua nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA), në kuadër të hartimit të Dokumentit Ndërsëktorial Zhvillues për Moshimin nga MPÇSSH.B.

Në realizimin e këtij botimi, një ndihmesë të rëndësishme ka dhënë, sidomos në hartimin e **pyetsorit, Grupi i Punës i përbërë nga:**

Znj. Anna Xheka	Drejtuuese e grupit
Znj. Valbona Jaupllari	Anëtare
Z. Ali Emrini	Anëtar
Znj. Eda Pëllumbi	Anëtare
Znj. Mimoza Bajrami	Anëtar
Znj. Mira Pirdeni	Anëtare
Z. Ali Emrini	Anëtar

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike në procesin konsultues

Znj. Jonida Nazarani

Plotësimi i pyetsorëve dhe realizimi i intervistave në të gjithë territorin e vendit është realizuar nga:

Znj. Dhora Naço	Tiranë
Znj. Alma Laska	Berat
Z. Latif Çiku	Dibër
Znj. Odeta Garori	Durrës
Znj. Lorena Nishku	Elbasan
Znj. Fatmira Vrushaj	Fier
Znj. Kozeta Gogo	Gjirokastër
Z. Ftitim Mitre	Korçë
Znj. Fatbardha Gjana	Kukës
Z. Gazmor Dervishi	Lezhë
Z. Agim Abazi	Shkodër
Z. Erjon Petraj	Vlorë
Z. Fojton Dhame	Sarandë
Znj. Majlinda Murati	Tiranë
Znj. Drita Bababmeto	Tiranë

Përpunimi statistikor është realizuar nga
Prof. Fatmir Memë

Falenderojmë stafin e UNFPA-së dhe, në mënyrë të veçantë, Dr. Manuela Bello, Znj. Elida Nuri dhe Znj. Flora Ismaili për mbështetjen e vazhdueshme në realizimin e këtij vrojtimi.

I. GJETJET KRYESORE	1
A. ANALIZA EVROJITIMIT: PAMJE E PËRGJITHSHME	2
1. Të dhëna demografike dhe ekonomike	3
2. Të dhëna ekonomike dhe sociale	4
3. Të dhëna shëndetësore	5
4. Angazhime në komunitet	6
5. Të ndryshme	6
B. METODOLOGJIA E VROJTIMIT	7
1. Faza I - Mobilizimi i ekspertëve, kërkimi paraprak i literaturës dhe misioni i takimeve në terren	7
2. Faza II - Hartimi i kampionit të vrojtimit, metodologjisë së vrojtimit dhe zbatimit i saj në terren nëpërmjet intervistave me pyetësorë	7
3. Përzgjedhja e kampionit	7
4. Mbledhja e të dhënave	8
5. Përpunimi i të dhënave	9
C. PROBLEMATIKA KRYESORE	9
D. MODELE TË NDRYSHME BOTËRORE TË TRAJTIMIT TË MOSHËS SË TRETË	11
II. ANALIZA E VROJTIMIT: PAMJE E PËRGJITHSHME	12
A. TË DHËNA DEMOGRAFIKE DHE EKONOMIKE	13
B. TË DHËNA EKONOMIKE DHE SOCIALE	15
C. TË DHËNA SHËNDËTËSORE	18
D. ANGAZHIME NË KOMUNITET	19
E. TË NDRYSHME	20
III. ANALIZA E VROJTIMIT: GJETJET KRYESORE	23
A. TË DHËNA EKONOMIKE DHE SOCIALE	24
B. TË DHËNA SHËNDËTËSORE	44
C. ANGAZHIME NË KOMUNITET	52
IV. REKOMANDIME	58
1. Pjesëmarrja aktive në shoqëri dhe në zhvillim	59
2. Punësimi i personave të moshuar	59
3. Forcimi i solidaritetit përmes barazisë dhe reciprocitetit midis brezave	59
4. Zhvillimi rural, migrimi dhe urbanizimi	60
5. Sigurimi shoqëror, mbrojtja sociale dhe parandalimi i varfërisë	60
6. Akses i barabartë në shërbimet shëndetësore	60
7. Personat e moshuar dhe paaftësia	60
8. Banimi dhe mjedisi i jetesës	61
9. Kujdesi dhe mbështetja e personave që ofrojnë mbështetje	61
SHTOJCA	62

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, mbështetur në Planin Ndërkombëtar të Veprimit të Madridit, në Deklaratën Ministeriale të Leonit, në dokumenta të tjera ndërkombëtare për moshimin, si edhe duke iu referuar kushteve konkrete të vendit tonë, ndërmori iniciativën për hartimin e Dokumentit Ndërsëktorial Zhvillues për Moshimin(DNZHM). Në këtë kuadër u ngrit grupi i punës, i cili, si hap të parë, ndërmori mbledhjen e informacionit nga të gjitha burimet primare dhe sekondare, si edhe statistikat që disponoheshin nga institucionet publike në lidhje me personat e moshuar.

Për një njohje më në thellësi të situatës të personave të moshuar në Shqipëri, u iniciua vrojtimi me shtrirje të gjerë territoriale mbi bazën e plotësisht, përpunimit të pyetësorëve, si dhe realizimit të intervistave me persona të moshuar. Hartimi i pyetësorit u konceptua në trajtimin e disa çështjeve si: a) të dhëna demografike; b) të dhëna ekonomike dhe sociale; c) të dhëna shëndetësore; d) angazhime në komunitet; e) të ndryshme.

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave në këtë vrojtim është bërë, përveç ndarjeve të mësipërme, edhe sipas gjinisë.

Qëllimi i studimit është që të bëhet një vlerësim i situatës së respektimit të të drejtave politike, ekonomike e sociale të personave të moshuar, duke u mbështetur në parimin e krijimit të mundësive të barabarta për të gjithë, për pjesmarrje në të gjithë proceset zhvilluese të vendit.

Përmes përpunimit të të dhënave të vrojtimit, si dhe interpretimit të tyre, synohet që të bëhet një vlerësim i situatës aktuale të personave të moshuar në Shqipëri, një analizë e pabarazive, si dhe identifikimi i nevojave të këtij target grupi, për një jetë më cilësore dhe të sigurtë dhe një angazhim më të madh në proceset vendimmarrëse dhe në jetën komunitare.

Konkluzionet e dala nga vlerësimi cilësor dhe sasior i të dhënave të vrojtimit, si dhe materializimi i tyre në rekomandime konkrete kanë vlerën e një orientimi se ku mund të përqendrohet më shumë puna e politikbërësve dhe aktorëve të tjerë në përmirësimin e statusit aktual të personave të moshuar.

Rezultatet e këtij studimi, si edhe të studimeve të tjera të realizuara nga aktorë të ndryshëm, përbëjnë një bazë mbështetëse për grupin e punës në hartimin e DNZHM dhe të Planit respektiv të Veprimit 2009-2013. Ato gjithashtu mund të përdoren nga të gjitha institucionet dhe OJF-të që kanë detyra, role dhe përgjegjësi në mbrojtjen e të drejtave të personave të moshuar.

Ky studim u mundësua nga UNFPA (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë), në kuadrim e projektit për hartimin e Dokumentit Ndërsëktorial Zhvillues për Moshimin me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

A. ANALIZA E VROJTIMIT: PAMJE E PËRGJITHSHME

1. Të dhëna demografike dhe ekonomike

Sondazhi përzgjedhi një kampion me të anketuar, ku 69.3% janë nga zonat urbane dhe 30.7% nga zonat rurale, me një ndarje gjinore të barabartë dhe një kategori moshë mbi 55 vjeç, ku pjesa kryesore përqëndrohet midis 61-70 vjeç.

Gjithashtu, sondazhi pati një shtrirje territoriale të gjerë, duke përfshirë të 12 prefekturat e vendit. Numri i pyetësorëve të shpërndarë nëpër prefektura iu referua të dhënave të SSH dhe INSTAT-it mbi shpërndarjen e personave të moshuar mbi 60 vjeç në të gjithë vendin.

Tab : Mesatare vjetore 2007

	Gjithsej	Meshkuj	Femra
0-4	235302	123046	112256
5-9	253793	132777	121016
10-14	286308	147958	138350
15-19	313936	161708	152228
20-24	295727	147905	147822
25-29	235258	113683	121575
30-34	206086	98976	107110
35-39	209124	101371	107753
40-44	206518	102083	104435
45-49	211488	107301	104187
50-54	173514	88893	84621
55-59	141043	72321	68722
60-64	109574	56104	53470
65-69	105484	52256	53228
70-74	80010	40034	39976
75-79	53319	24567	28752
80-84	27870	10696	17174
85-89	13478	4789	8689
90-94	3013	907	2106
95+	492	121	371
Total	3161337	1587496	1573841

Burimi: INSTAT



Të anketuarit janë në pjesën më të madhe të martuar (61.5%) dhe më pak prej tyre janë të ve (33%), duke pasur në përgjithësi dy ose më shumë fëmijë të cilët jetojnë në një përqindje të barabartë si brenda, edhe jashtë vendit.

Familja vazhdon të jetë shumë e rëndësishme në shoqërinë shqiptare, fakt që vërtëtohet dhe nga studimi, ku të anketuarit deklarojnë se ata vazhdojnë të jetojnë me fëmijët e tyre.

Pjesa më e madhe e të anketuarve kanë dalë në pension kryesisht midis viteve 1991-2000 dhe pjesa tjetër ka dalë kryesisht midis viteve 1981-1990 dhe 2001-2008.

2. Të dhëna ekonomike dhe sociale

Vrojtimi ka vlerësuar si një komponent të rëndësishëm komponentin ekonomik dhe social, duke synuar njohjen e situatës ekonomike dhe sociale të personave të moshuar, sipas zonave urbane dhe rurale dhe gjinisë dhe është përqendruar në profesionet dhe vitet e punës që kanë bërë para se të dalin në pension, në të ardhurat dhe burimet e këtyre të ardhurave, në shpenzimet kryesore, në mënyrën e kalimit të kohës së lirë dhe në shkallën e informacionit që zotërojnë në lidhje me shërbimet sociale, që ofrohen për moshën e tyre nga subjekte publike dhe private.

Të anketuarit i përkasin profesioneve të ndryshme, por më të përhapurat janë kryesisht ai i punëtorit, i ndjekur nga ai i bujkut dhe ai i edukatores/mësueses. Në zonat urbane pjesa më e madhe e të anketuarve janë kryesisht punëtorë, por nuk mungojnë edhe profesionet e arkëtarit, kuzhinierit dhe ekonomistit. Më pak të përfaqësuar janë profesionet dentit, mjek, instruktor e mekanik. Në zonat rurale, profesioni që kryeson është ai i bujkut, punëtorit dhe më pak blegtorë e mësues.

Profesionet më të përhapura për femrat janë ato të bujkut, punëtorit, secili me 38.5%. Gjithashtu femrat rezultojnë më shumë të punësuar në profesionet që nuk kanë nevojë për nivele të larta shkolli (punëtor, bujk), kjo duke vërtetuar akoma më shumë konkluzionet e nxjerra edhe nga raporte të tjera se femrat janë më të diskriminuara në tregun e punës dhe më pak aktive për të ngjitur shkallët e karrierës.

Përsa i përket viteve që kanë punuar para se të dalin në pension, pjesa më e madhe kanë punuar 31-40 vjet dhe, një pjesë më e vogël të punuar midis 21-30 vjet. Por momentalisht shumica e tyre janë pa punë dhe vetëm 15.9% vazhdojnë të punë në punë.

65.7% e të anketuarve kanë të burime të tjera të ardhurash, sidomos në zonat rurale. Burimet e tjera të të ardhurave shtesë janë kryesisht nga brenda vendit dhe nga fëmijët emigrantë. Femrat i kanë të ardhurat shtesë më shumë nga brenda vendit, se sa meshkujt, por meshkujt i kanë të ardhurat shtesë nga fëmijët emigrantë më shumë se femrat.

Nivelet e varfërisë janë më të mëdha në zonat rurale, sesa në zonat urbane.

Të ardhurat përdoren kryesisht për ushqime, pagesa të energjisë elektrike, ujit dhe detyrimeve të tjera, për ilaçe dhe shumë pak për argëtim, veshmbathje apo orëndi shtëpiake.

3. Të dhëna shëndetësore

Në lidhje me komponentin shëndetësor, i cili është edhe komponenti që prek pjesën më të madhe të personave të moshuar, anketimi u përqendrua në sëmundshmërinë.

Pjesa më e madhe e të anketuarve vuajnë nga një sëmundje, sidomos në zonat rurale. Kategoria e moshës më të prekur nga sëmundjet është midis 66-70 vjeç, e ndjekur nga kategoria e moshës 61-65 vjeç. Por 51.3% vuajnë nga më shumë se një sëmundje, sidomos në zonat urbane dhe kryesisht ata që janë mbi moshën 70 vjeç.

Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarëve mendojnë se është e nevojshme asistenca e personave të tjerë, sidomos ata që janë 76 vjeç e sipër, ndërsa një pjesë më e vogël mendojnë se është pjesërisht e nevojshme. Megjithatë predominon mendimi se kjo asistencë nuk është e nevojshme.

Pjesa më e madhe e të pyeturve nuk vizitohen pa shkak tek mjeku i familjes, duke mos përjashtuar vizita sporadike edhe pa shkak.

Rreth gjysma e të intervistuarve janë shprehur se nuk janë as të pakënaqur, as të kënaqur për shërbimin shëndetësor në poliklinika, sidomos ata nga zonat rurale dhe po kaq janë shprehur se nuk janë as të pakënaqur, as të kënaqur për shërbimin shëndetësor në spitale. Një masë prej 69.5% e tyre shprehen të pakënaqur mbi skemën e rimbursimit të ilaçeve.

Pjesa më e madhe e të anketuarve nuk pijnë as duhan, as alkool dhe as nuk kërkojnë të mbajnë dietë, por mbajnë dietë për ata që e mbajnë, kërkon shpenzime mujore shtesë, duke shpenzuar më shumë se 1000 lekë për mbajtjen e dietës.

4. Angazhime në komunitet

Në lidhje me angazhimet në komunitet, anketimi u përqendrua në shkallën e përfshirjes së personave të moshuar në proceset vendimmarrëse apo konsultative në bashki/komunë në zonën e tyre, sidomos në zonat rurale dhe duke e parë edhe nga aspekti gjinor.

Pjesa më e madhe e të anketuarve deklaroi se nuk përfshihen në procese vendimmarrëse apo konsultative. Megjithatë, ata mendojnë se janë të aftë për të kontribuar në shoqëri, duke e rënditur familjen si kategori kryesore, e ndjekur nga angazhimi me punë, organizata dhe shoqata joqeveritare dhe jetën kulturore e shkencore.

Një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë punuar edhe mbas daljes në pension, sidomos ata që jetojnë në zonat urbane dhe, më shumë, meshkujt.

5. Të ndryshme

Në përgjithësi 83.4% kanë në pronësi një banesë dhe gjysma e të anketuarve marrin kompensim për energjinë elektrike, por bashkia/komuna nuk i ndihmon me asnjë lloj ndihme.

Shërbimi urban përdoret mesatarisht deri 10 herë në muaj nga 90.9% e të anketuarve dhe pjesa tjetër deklaroi se e përdor atë më shumë se 10 herë.

Një komponent i anketimit ishte edhe trajtimi i abuzimit dhe dhunës që ushtrohet ndaj personave të moshuar. Kjo pjesë është realizuar nga anketuesit në formën e një interviste, sepse gjithmonë ka frikime: ose nuk e deklaroi, ose fshihin dhunën apo abuzimin që është ushtruar mbi ta. Për personat e moshuar ky mosdeklarim është më i madh, për shkak se janë më tradicionale dhe më të lidhur me mentalitetin se “gëshjtet e shtëpisë nuk janë për nëe pazar”.

Dhuna ndaj të intervistuarve është ushtruar në radhë të parë nga nusja, e ndjekur nga bashkëshorti/tja, vajza/djali dhe në fund dhe nga të afërmit dhe nipi, kryesisht në formë dhune psikologjike dhe, më pak, fyrie ose dhunë fizike.

Problemet kryesore për të anketuarit, që mund të ndikojnë në përmirësimin e jetës së tyre, janë rritja e pensioneve, ulja e çmimeve/taksave, përmirësimi i kujdesit shëndetësor si dhe rimbursimi i ilaçeve.

B. METODOLOGJIA E VROJTIMIT

Projekti u zbatua në bazë të etapave të mëposhtme, duke përdorur metoda cilësore dhe sasore:

1. Faza I - Mobilizimi i ekspertëve, kërkimi paraparak i literaturës dhe misioni i takimeve në terren

Qëllimi i kësaj faze ishte krijimi i kanaleve të përshtatshme të komunikimit midis ekipit të ekspertëve, po ashtu dhe me burimet njerëzore dhe institucionale të përfshira në zbatimin e studimit dhe në mbledhjen e të dhënave, studimeve, dokumentave, raporteve të përgatitura nga institucione/organiza të tjera që mund të ishin të përshtatshme për këtë detyrë.

Në kuadër të kësaj faze u arrit mobilizimi i ekspertëve sipas specifikave të kërkuara nga UNFPA, identifikimi i aktorëve dhe institucioneve të ndryshme dhe vendosja e kontakteve me to, grumbullimi i dokumenteve, raporteve dhe studimeve të cilat u konsultuan për të siguruar informacion, duke përfshirë të dhëna statistikore, materiale legjislative dhe raporte të mëparshme.

Një seri takimesh u realizuan me aktorët dhe institucionet e identifikuara nga ekipi i ekspertëve, për të marrë mendimin e tyre.

2. Faza II – Hartimi i kampionit të vrojtit, metodologjisë së vrojtit dhe zbatimi i saj në terren nëpërmjet intervistave me pyetsorë

Objekti kryesor i kësaj faze ishte mbledhja e të dhënave dhe informacionit, nëpërmjet vrojtit të grupeve të synuara, që janë të nevojshme për një karakterizim të detajuar të grupeve të moshimit në Shqipëri dhe analiza e problemeve të lidhura me ta. Kjo është një nga fazat më të rëndësishme të projektit.

Vrojtimi konsistoi në intervista të drejtpërdrejta me 361 të anketuar, duke filluar nga 55 vjeç deri mbi 90 vjeç.

3. Përzgjedhja e kampionit

Hartimi i kampionit konsistoi në një proces dy fazësh, ku, në në fillim, u përzgjedhën shpërndarja gjeografike dhe numri i të intervistuarve dhe, më pas, përzgjedhja e

metodës së anketimit të rastësishëm të të intervistuarve në bazë të kriterëve të ndryshme si numri i popullsisë, madhësia e saj, zhvillimi ekonomik i zonave, etj.

Përzgjedhja e shembullit/kampionit u krye në bazë të konsultimit të literaturës përkatëse, raporteve të mëparshme, takimeve me ekspertët e fushës, dhe sidomos në bazë të komenteve dhe rekomandimeve të ekspertëve të ndryshëm.

4. Mbledhja e të dhënave

Në kuadër të qëllimit të projektit, përtë hartuar një analizë sa më të qartë dhe të plotë, ekipi i ekspertëve hartoi një pyetësor të plotë që mbulon të gjithë problematikën e moshimit.

Para zbatimit të vërtetimit, të tre ekipet e intervistimit, (secili prej tyre konsistonte në 2 intervistues dhe një mbikqyrës), gjithsej 6 intervistues dhe 3 mbikqyrës, janë trajnuar nëpërmjet një kursi trajnimi intensiv një ditë lidhur me metodologjinë e vërtetimit, karakteristikat specifike të pyetësorëve dhe pyetjet specifike në to, si edhe kërkesat specifike që duhet të zbatohen gjatë vërtetimit. Intervistuesit u trajnuan gjithashtu lidhur me mënyrën se si të krijojnë besim tek të intervistuarit dhe si të marrin përgjigje të sinqerta dhe të qarta nga ata. Ekipi i intervistuesve u krijua nga pedagogë të lëndës së statistikës në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Tiranës, si dhe anëtarë të ekipit të ekspertëve. Ekipi i intervistuesve mori udhëzime të shkruara mbi zhvillimin e vërtetimit, shpërndarjen e pyetësorëve, mjete identifikimi si pjesëtarë të projektit, si dhe një raport intervistuesi, i cili u plotësua në fund të intervistave.

Pavarësisht faktit se ekipi ka eksperiencë në studime/projekte të tjera, drejtuesi i projektit hartoi metodat e nevojshme lidhur me zhvillimin korrekt dhe verifikimin e intervistave. Për këtë qëllim u përzgjedhën rastësisht 5-10% të të intervistuarve, të cilët u pyetën lidhur me zhvillimin e intervistave.

Para se pyetësorët të shpërndaheshin tek ekipi i intervistuesve, ato u testuan në masën 5% të të gjithë kampionit, për t'u siguruar që pyetësorët janë të qartë, të kuptueshëm, për të parë reagimin e intervistuesve lidhur me zgjatjen e intervistës, përgjigjet e marra si dhe nëse i shërbejnë qëllimit të projektit.

Problemet e hasura, si dhe sugjerimet e marra gjatë periudhës së testimit u pasqyruan në pyetësorët para se ata ti jepeshin ekipit të intervistuesve.

5. Përpunimi i të dhënave

Menjëherë mbasi pyetësorët u dorëzuan në zyrat e ekspertëve të konsorciumit 2A në Tiranë, u realizua një kontroll vizual dhe logjik i të gjithë pyetësorëve lidhur me mosplotësimin e tyre ose gabime të mundshme në plotësim. Kontrolli të tjera logjike u hartuan për të kontrolluar mbas hedhjes së të dhënave në bazën kompiuterike. Gjatë kontrollit rezultoi se nuk kishte pyetësorë me gabime. Mbas përfundimit të procesit të kontrollit, dy operatorët filluan hedhjen e të dhënave në një format Excel. Analiza e të dhënave u krye nëpërmjet softit të përpunimit të të dhënave statistikore (SPSS), në atë mënyrë që rezultatet e analizës mund të lexohen në çdo paketë standarde softi MS. Forma të ndryshme raportimi, duke përfshirë korelacione dhe cross-tabulation, u përgatitën në mënyrë që të interpretohen rezultatet dhe të hartohen konkluzionet dhe rekomandimet e përshatshme.

Përpunimi i të dhënave u krye nga një ekspert i statistikës, i cili ka eksperiencë të gjerë duke marrë pjesë dhe në shumë projekte të tjera.

C. PROBLEMATIKA KRYESORE

Gjendja vulnerabel në të cilën ndodhet moshja e tretë është një fenomen global, që prej kohësh ka shqetësuar vendet e zhvilluara, fenomen ky, që ka filluar të ndihet në mënyrë shqetësuese edhe në Shqipëri. Ndonëse më parë moshimi i popullsisë është trajtuar si çështje e një rëndësie të vogël, ai përbën një ndryshim demografik, efektet e thella të të cilit shfaqen në të gjitha aspektet e jetës individuale e kolektive të vendeve të veçanta dhe të komunitetit ndërkombëtar në tërësi.

Moshja e tretë në Shqipëri bën pjesë ndër kategoritë më në nevojë, ndërsa financiarisht trajtohet kryesisht me pensione. Kjo moshë përfiton pensionin e pleqërisë, rimbursimin e një pjese të ilaçeve dhe, në mënyrë sporadike, ndonjë shërbim tjetër që nuk ndikon në përmirësimin e gjendjes së tyre materiale. Ekzistojnë diferenca të mëdha ndërmjet pensioneve të fshatit dhe qytetit, derisa pensioni mesatar i pleqërisë në qytet është afërsisht 12,000 lekë dhe në fshat 5,000 lekë.

Problemet e moshës së tretë do të vijnë duke u rënduar në Shqipëri për faktin që pasojat e industrializimit e konsumizmit të shoqërisë kanë filluar të ndihen edhe këtu. Ka një rritje me ritme të larta të popullsisë së moshuar dhe ritmet e rritjes do të vazhdojnë.

Parashikimet demografike tregojnë një rritje të moshës së popullsisë, që do të thotë rritje e atyre që duhet të mbulohen nga skema e pensioneve; rreth 15% e popullsisë merr pension pleqërie dhe tendenca është në rritje. Ndryshimet që ndodhën në sistemin e pensioneve pas aplikimit të skemës së re të pensioneve (pas vitit 1993), kanë krijuar diferencë në pagesën e pensionistëve, duke diskriminuar të gjithë ata që kanë dalë në pension para aplikimit të kësaj skeme e duke rritur në këtë mënyrë koston financiare për të përmirësuar gjendjen. Ndërsa sigurimi i popullsisë për pension në Shqipëri ka filluar të bëhet një problem që do të rëndohet më shumë me kalimin e viteve.

Problematika e moshës së tretë qëndron kryesisht:

- Të ardhura jo të mjaftueshme për personat në këtë moshë;
- Shërbime sociale jo me kapacitet të plotë;
- Shërbime shëndetësore, që nuk garantojnë nevojat në sasi dhe cilësi;
- Skema e kompensimit të ilaçeve nuk mbulon plotësisht nevojat e tyre;
- Nuk ekziston një asistencë e vërtetë geriatrike dhe as kurse specializimi për mjekë të kësaj fushe. Edhe sistemi i kujdesjes në shtëpi është në fillimet e saj.

Mundësitë e mospërmirësimit dhe të kufizimit të aftësive rriten me rritjen e moshës, problem i cili ka nevojë për ofrimin e kurseve dhe politikave sociale për aftësimin e tyre.

Problemi i dhunës, neglizhencës apo abuzimit është i vështirë për t'u identifikuar për shkak të mentalitetit, traditës së vjetër të mbajtjes brenda familjes të problemeve të tilla, si dhe të nivelit kulturor në përgjithësi të shoqërisë dhe shkallës së hapjes së saj.

Pjesëmarrja më aktive e të gjithë moshave përfshin krijimin e mundësisë për personat e moshuar që të vazhdojnë të kontribuojnë në shoqëri dhe zhvillim.

Në këto zhvillime demografike, popullsia e moshuar pritet të dyfishohet në 20 vitet e ardhshëm. Ky moshim i popullsisë përbën një sfidë për të ardhmen. Vjetrimi i popullsisë ndikon mbi sistemin e pensioneve, shërbimet shëndetësore dhe produktivitetin ekonomik.

D. MODELE TË NDRYSHME BOTËRORE TË TRAJTIMIT TË MOSHËS SË TRETË

Sot në botë ekzistojnë sisteme të integruara të përkrahjes sociale, sipas të cilave shteti (Këshilli i Ministrave, bashkia, komuna) përkrah shtresat më në nevojë të popullsisë, ku në përgjithësi kategorizohen edhe pensionistët.

Kështu, në Britaninë e Madhe pensionistët përfitojnë falas ose me gjysmë çmimi biletat e transportit urban (çmimi në UK përcaktohet nga organet e pushtetit vendor), përfitojnë përjashtime nga taksat për lëndën djegëse në periudhën e dimrit, ndërsa kategori pensionistësh me të ardhura të ulta përfitojnë një kompensim në para për lëndë djegëse në dimër deri në 100%.

Të moshuarit të cilët kanë në varësi persona me aftësi të kufizuara, marrin një kompensim në të holla, që përcaktohet nga organet e pushtetit vendor.

Të moshuarit e pastrehë gëzojnë të drejtën e strehimit në banesat popullore, sipas përcaktimeve që bën pushteti vendor.

Në Hungari pensionistët, të cilët me pensionin që marrin nuk arrijnë një nivel të caktuar të ardhurash (të përcaktuar me ligj), kompensohen për një pjesë të të ardhurave nga organet e pushtetit vendor ku banojnë.

Aplikimi i lehtësirave fiskale nga organet e pushtetit qendror e vendor, për subjektet që i ofrojnë shërbime moshës së tretë, apo pjesë të fondeve të siguruara nga privatizimet strategjike të kalojnë në favor të kësaj moshe.

Shërbimin shëndetësor si e drejta e vizitës pa pagesë, tek mjekët specialistë.

A. TË DHËNA DEMOGRAFIKE DHE EKONOMIKE

Të intervistuarit e këtij anketimi janë përgjegjedhur në masën 69.3% nga zonat urbane dhe 30.7% nga zonat rurale.

Tab. 1. Zona e të intervistuarit

Zona	Gjithsej	Urban	Rural
Gjithsej	361	250	111
Në %	100	69.3	30.7

Ky sondazh u mendua që të jetë në një masë të barbartë i përfaqësuar nga përgjigjet e të anketuarve meshkuj (50.7%) dhe atyre femra (49.3%).

Tab. 2. Gjinia e të intervistuarit

Zona	Gjithsej	Femra	Meshkuj
Gjithsej	361	178	183
Në %	100	49.3	50.7

Të intervistuarit kanë një moshë midis 55 vjeç deri mbi 90 vjeç. Përqindja kryesore e të intervistuarve vëhet re midis moshave 66-70 vjeç me 23%, 61-65 vjeç me 20.5% dhe kategoritë e tjera të moshave me përqindje më të vogla.

Tab. 3. Moshë e të intervistuarit

Grup-moshë	56-60	61-65	66-70	71-75	76-80	81-85	86-90	mbi 90
Gjithsej	37	74	83	65	60	26	13	3
Në %	10.2	20.5	23	18	16.6	7.2	3.6	0.8

Statusi i gjendjes civile për të anketuarit është "të martuar" në masën 61.5% dhe "të ve" në masën 33%, por ekziston dhe një përqindje e vogël e kategorisë së beqarëve 2.5% dhe atyre të divorcuar 3%.

Tab. 4. Statusi i gjendjes civile i të intervistuarit

Statusi	Begar/e	i/e martuar	i/e divorcuar	i/e ve	Shuma
Gjithsej	9	222	11	119	361
Në %	2.5	61.5	3	33	100

Të anketuarit kanë në përgjithësi dy fëmijë në masën 32.1% dhe më shumë se dy

ANALIZA E VROJTIMIT:
PAMJE E PËRGJITHSHME



fëmijë në masën 50.1%, por një përqindje e vogël nuk kanë fëmijë (5.3%) ose kanë vetëm një fëmijë (12.5%).

Tab. 5. Sa fëmijë keni

Numri i fëmijëve	0	1	2	më shumë	shuma
Gjithsej	19	45	116	181	361
Në %	5.3	12.5	32.1	50.1	100

Fëmijët e të intervistuarve janë ndarë gati në masë të barabartë në Shqipëri dhe jashtë vendit.

Tab. 6. Fëmijët tuaj ndodhen

Zona	brenda vendit	jashtë vendit	shuma
Gjithsej	185	176	361
Në %	51.2	48.8	100

Vitet re një tendencë e një familje të bashkuar në shoqërinë shqiptare, ku 42.4% e të anketuarve deklaroi se vazhdon të jetojë me fëmijët dhe 33.8% e tyre me bashkëshorten/in, ndërsa 19.7% e tyre janë vetëm. Një kategori shumë e vogël mban asistente (0.3%) dhe vetëm 3.9% jeton me një tjetër.

Tab. 6. Ju jetoni

i/e vetme	me bashkëshorten/in	me fëmijët	mbaj asistente	Tjetër	shuma
71	122	153	1	14	361
19.7%	33.8%	42.4%	0.3%	3.9%	100.0%

Pjesa më e madhe e pjesëtarëve të tjerë të familjes sigurojnë të ardhura për të anketurit dhe vetëm 28.8% e tyre nuk sigurojnë.

Tab. 7. A ka pjesëtarë të tjerë në familjen tuaj që sigurojnë të ardhura

jo	po	shuma
104	257	361
28.8%	71.2%	100.0%

Të anketuarit kanë dalë në pension kryesisht midis viteve 1991-2000 në pjesën më të madhe 40.2%, të ndjekur nga kategoria prej 27.4% që kanë dalë midis viteve 1981-1990 dhe 24.5% që kanë dalë midis viteve 2001-2008 dhe një përqindje më e vogël 7.9% kanë dalë në 1980 dhe më parë.

B. TË DHËNA EKONOMIKE DHE SOCIALE

Tab. 8. Nëse po: viti i daljes në pension _____ vite në pension _____ pensioni mujor _____ lekë

Numri i pensionistëve	%
deri me 1970	1.10%
1971-1980	6.80%
1981-1990	27.40%
1991-2000	40.20%
2001-2008	24.50%
shuma	100.00%

Profesionet më të përhapura në radhët e të intervistuarve janë ato të punëtorit me 37.3%, e ndjekur nga ai i bujkut me 12% dhe ai i edukatorës/mësueses me 11.7%. Profesionet e tjera janë gjithashtu të deklaruar nga të intervistuarit, por në masën nën 10%.

Tab. 9. Profesionet që keni patur para daljes në pension

Profesioni	Numri	%
agronom	4	1.1%
artist	2	0.6%
Arkëtar	9	2.6%
blegtor	3	0.9%
bujk	42	12.0%
dentist	1	0.3%
edukator/mësues	41	11.7%
ekonomist	14	4.0%
elektricitist	2	0.6%
gjeolog	1	0.3%
kuzhinier	4	1.1%
mjek/infermier/laborent/	10	2.8%
inxhinier	3	0.9%
jurist	1	0.3%
mekanik	11	3.1%
minator	7	2.0%
nëpunës	11	3.1%
përkthyes	1	0.3%
punëtor	131	37.3%

shofer	11	3.1%
rrobapëpës	7	2.0%
sanitar	9	2.6%
Shtëpiak	2	0.6%
ushtarak	23	6.6%
veteriner	1	0.3%
shuma	351	100.0%

Kryesisht të intervistuarit kanë punuar 31-40 vjet para daljes në pension në masën 62.7%, por 25.4% e tyre kanë punuar midis 21-30 vjet. Një pjesë e tyre e vogël (0.6%) ka punuar deri në 10 vjet, 4.6% ka punuar 11-20 vjet dhe vetëm 6.8% ka punuar mbi 40 vjet.

Tab. 10. Sa vite keni punuar para daljes në pension

deri në 10 vjet	11-20 vjet	21-30 vjet	31-40 vjet	mbi 40 vjet	shuma
2	16	89	220	24	351
0.6%	4.6%	25.4%	62.7%	6.8%	100.0%

Aktualisht, statusi i punësimit të të intervistuarve është "pa punë" në masën 84.6% dhe vetëm 15.4% janë në punë.

Tab. 11. Statusi i punësimit

pa punë	në punë	shuma
297	54	351
84.60%	15.40%	100.00%

Tab. 12. Konsumi mesatar mujor i familjes tuaj për disa produkte (në lekë)

Produktu	Lekë	Përqindje
Bukë	2,792	22.7%
mish dhe nënproduktet e tij	711	5.8%
Qumësht dhe nënproduktet	2,650	21.5%
perime dhe patate	2,428	19.7%
fruta dhe agrume	1,721	14.0%
kafe	109	0.9%
Tjetër	1,910	15.5%
Total	12,321	100.0%

Të anketuarit janë përgjigjur në masën 73.4% se nuk ka tregues të jashtëm cilësorë në qendra dhe 26.6% e tyre janë përgjigjur se kanë.

Tab. 13. A kanë tregues të jashtëm cilësorë

po	jo	shuma
29	80	109
26.6%	73.4%	100.0%

Vihet re një nevojë e rëndësishme për të ngritur kapacitetet në qendra, e cila vlerësohet në masën 30% nga të intervistuarit, e ndjekur nga 28.8% e tyre të cilët vlerësojnë shërbimin shëndetësor, si dhe kualifikimin e stafit, ushqimin dhe argëtimin në përqindje më të vogla.

Tab. 14. Nëse nuk ka tregues të jashtëm cilësorë, çfarë do të ishte e nevojshme të ndryshohej, përmirësohej në këto qendra

shërbimi shëndetësor	kapaciteti	kualifikimi i stafit	ushqimi	argëtimi	tjetër	shuma
23	24	11	11	9	2	80
28.8%	30.0%	13.8%	13.8%	11.3%	2.5%	100.0%

Shumica e të intervistuarve (55.4%) deklarojnë se gjendja e tyre shëndetësore është mesatarisht njësoj me vitin e kaluar, por 36% mendojnë se gjendja e tyre është përkeqësuar.

Tab. 15. Si e vlerësoni gjendjen tuaj shëndetësore në krahasim me vitin e kaluar

më keq	njësoj	më mirë	nuk e di	shuma
130	200	27	4	361
36.0%	55.4%	7.5%	1.1%	100.0%

Shpenzimet për ilaçe zënë një pjesë të konsiderueshme të buxhetit të të anketuarve, por vetëm 50% e shpenzimeve disbursohen nga shteti.



C. TË DHËNA SHËNDETËSORE

Tab. 16. Sa janë shpenzimet mujore

lloje	3173.01 lekë
nga këto disbursohen	1577.42 lekë

Një tendencë pozitive vihet re tek të intervistuarit të cilët nuk janë përdorues të rregullt të duhanit në masën 73.7% dhe vetëm 26.3% e tyre e përdorin zakonisht ose rallë.

Tab. 17. A jeni përdorues i rregullt i duhanit

jo	po	rallë	shuma
266	72	23	361
73.7%	19.9%	6.4%	100.0%

Po ashtu, ata nuk janë përdorues të rregullt të alkoolit gati në të njëjtën masë si dhe për duhanin, duke e përdorur alkoolin vetëm 6.9% e tyre rregullisht dhe 17.7% më rallë.

Tab. 18. A jeni përdorues i rregullt i alkoolit

jo	po	rallë	shuma
272	25	64	361
75.3%	6.9%	17.7%	100.0%

Përdoruesit e rregullt të alkoolit deklarojnë se 60.1% e tyre e përdorin atë çdo ditë, ndërsa pjesa tjetër e përdor 1 herë, 2 herë ose 3 herë në javë në përqindje më të vogla.

Tab. 19. Nëse jeni përdorues i rregullt i alkoolit, sa herë në javë pini

1 herë	2 herë	3 herë	çdo ditë	shuma
9	47	61	176	293
3.1%	16.0%	20.8%	60.1%	100.0%

Të anketuarit i përdorin kryesisht ushqimet shëqerore nga pjesa më e madhe e tyre (49.3%) tre herë në ditë dhe vetëm 29.9% e tyre i përdor 1 herë në ditë, kurse 20.8% i përdor dy herë në ditë. Ata po ashtu përdorin ushqimet protejnikë dy herë në ditë në masën 65.9%, 22.4% një herë në ditë dhe vetëm 11.6% e tyre i përdor 3 herë në ditë. Zarzavatet dhe frutat përdoren një herë në ditë nga 46.8% e tyre, ndërsa 25.8% i përdor dy herë në ditë dhe vetëm 27.4% i përdor tre herë në ditë.

Tab. 20. Renditja e konsumit të ushqimeve sipas përbajtjes

shëqerore	1	2	3	shuma
	108	75	178	361
	29.9%	20.8%	49.3%	100.0%
protejnikë	81	238	42	361
	22.4%	65.9%	11.6%	100.0%
zarzavate dhe fruta	169	93	99	361
	46.8%	25.8%	27.4%	100.0%

Kryesisht 55.4% e të anketuarve nuk kërkojnë të mbajnë dietë, por janë edhe 44.6% e tyre që kërkojnë ta mbajnë.

Tab. 21. A kërkon të mbani dietë

jo	po	shuma
200	161	361
55.4%	44.6%	100.0%

Mbajtja e dietës kërkon shpenzime mujore shtesë nga të intervistuarit, 95% e të cilëve shprehin se ata shpenzojnë deri në 10,000 lekë për mbajtjen e dietës dhe 5% e tyre shpenzon më shumë se 10,000 lekë për mbajtjen e saj.

Tab. 22. Nëse kërkon të mbani dietë, afërsisht sa lekë shpenzime mujore shtesë kërkon dieta

deri në 10000	mbi 10000	shuma
153	8	161
95.0%	5.0%	100.0%

D. ANGAZHIME NË KOMUNITET

Arsyet kryesore të të anketuarve pse nuk kanë punuar mbasi kanë dalë në pension janë se ata nuk ndjehen më të aftë nga ana shëndetësore me 33.7%, nuk kanë mbështetje për mbarëvajtje në familje me 23.2% dhe nuk kanë gjetur punë me 22%. Po ashtu, ekzistojnë arsye të tjera si p.sh. nuk janë lejuar nga pjesëtarët e familjes dhe nuk kanë patur nevojë, me përqindje më të vogla përfaqësimi.

Tab. 23. Nëse mbas daljes në pension nuk keni punuar, jepni arsyet

nuk keni gjetur punë	mbështetje për mbarrëvajtje në familje	nuk ndjehemi të aftë nga ana shëndetësore	nuk ju kanë lejuar pjestarët e familjes	nuk keni patur nevojë	tjetër	shuma
54	57	83	30	18	4	246
22.0%	23.2%	33.7%	12.2%	7.3%	1.6%	100.0%

Familja e bashkuar në shoqërinë shqiptare vërtetohet dhe nga përgjigjet e kësaj pyetje, ku rezultoi se 46.5% e të anketuarve vazhdon të jetojë me fëmijët, 32.1% jeton vetëm dhe 4.2% me të afërm të tjerë si dhe 16.3% me të tjerë. Një kategori shumë e vogël prej 0.8 jeton në azil.

Tab. 24. Me kë jetoni

vetëm	me fëmijët	me të afërm të tjerë	azil	tjetër	shuma
116	168	15	3	59	361
32.1%	46.5%	4.2%	0.8%	16.3%	100.0%

E. TË NDRYSHME

Në përgjithësi 83.4% e të intervistuarve kanë në pronësi një banesë dhe vetëm 16.6% e tyre nuk kanë.

Tab.25. A keni banesë në pronësinë tuaj

jo	po	shuma
60	301	361
16.6%	83.4%	100.0%

Të anketuarit marrin kompensim për energjinë elektrike në masën 46% të tyre, ndërsa 44% nuk e marrin, por janë dhe 10% që përgjigjen se nuk e dinë nëse marrin kompensim.

Tab.26. A merrni kompensim të energjisë elektrike

jo	po	nuk e di	shuma
159	166	36	361
44.0%	46.0%	10.0%	100.0%

Bashkia/komuna nuk i ndihmon me asnjë lloj ndihme sipas 95.8% të të anketuarve dhe vetëm 3.3% deklarojnë se ata marrin.

Tab.27. A merrni ndonjë lloj ndihme nga bashkia/komuna

jo	po	nuk e di	shuma
346	12	3	361
95.8%	3.3%	0.8%	100.0%

Të anketuarit nuk frekuentojnë qendra rezidence ditore dhe vetëm 3% e tyre deklarojnë se frekuentojnë.

Tab.28. A frekuentoni qendra rezidenciale ditore

jo	po	rrallë	shuma
343	11	7	361
95.0%	3.0%	1.9%	100.0%

Shërbimi urban përdoret mesatarisht deri 10 herë në muaj nga 90.9% e të intervistuarve dhe pjesa tjetër deklaroi se e përdor atë më shumë se 10 herë në muaj.

Tab.29. Mesatarisht sa herë në muaj përdorni shërbimin urban

deri 10 herë	11-20 herë	21-30 herë	më shumë se 30 herë	shuma
328	16	14	3	361
90.9%	4.4%	3.9%	0.8%	100.0%

Dhuna ndaj të intervistuarve është ushtruar nga nusia 25%, bashkëshorti/tja me 18.8%, vajza/djali 12.5%, po ashtu dhe nga të afërmit dhe nipit.

Tab.30. Nëse jeni dhunuar, specifikoni nga kush

nusia	vajza/djali	bashkëshorti/tja	të afërm	nipi	pa përgjigje	shuma
4	2	3	1	1	5	16
25.00%	12.50%	18.80%	6.30%	6.30%	31.30%	100.00%

Dhuna e ushtruar kryesisht ka qenë në formë dhune psikologjike në masën 43.8%, e ndjekur nga fytyrje me 18.8%, si dhe dhunë fizike në një shkallë më të vogël prej 6.3%.

Tab. 31. Njëse jeni dhunuar, specifkoni si

fytyrje	3	18.8%
dhunë psikologjike	7	43.8%
dhunë fizike	1	6.3%
pa përvojje	5	31.3%
shuma	16	100.0%

Problemet kryesore për të intervistuarit, që mund të ndikojnë në përmirësimin e jetës së tyre, janë rritja e pensioneve, ulja e çmimeve/taksave, përmirësimi i kujdesit shëndetësor, si dhe rimbursimi i ilaçeve.

Tab. 32. Rëndisni tre problemet më të rëndësishme që gjykoni se përmirësojnë jetën tuaj

rritja e pensioneve	331	91.7%
përmirësimi i kujdesit shëndetësor	150	41.6%
rimbursimi i ilaçeve	91	25.2%
ulja e çmimeve/taksave	255	70.6%
infrastruktura	27	7.5%
rritja e pastërtisë së ambienteve	10	2.8%
rritja e sip. të gjelbërta	4	1.1%
ulja e moshës së pensionit	6	1.7%



A. TË DHËNA EKONOMIKE DHE SOCIALE

Nga vrojtimi rezultojn se nuk ka dallim midis të anketuarve nga zonat urbane (që përbëjnë rreth 70% të grupit të anketuar) me atë të zonave rurale (që përbëjnë 30% të totalit), lidhur me përqindjen e marrjes së pensione: 97.2% e tyre marrin pension dhe vetëm 2.8% nuk marrin.

Tab. 1. A merrni pension sipas zonave

zona	jo	po	shuma
urbane	7	243	250
%	2.8%	97.2%	100.0%
rurale	3	108	111
%	2.7%	97.3%	100.0%
totali	10	351	361
%	2.8%	97.2%	100.0%
			100.0%

Vrojtimi vihet re se nuk ka dallime lidhur me marrjen e pensione, duke regjistruar 96.1% ka anketuar një grup të formuar në mënyrë të barabartë për sa i përket barazisë gjinore, ku % të femrave dhe 98.4% të meshkujve që marrin pension me një dallim shumë të vogël.

Tab. 2. A merrni pension sipas gjinisë

gjinia	jo	po	shuma
femër	7	171	178
%	3.9%	96.1%	100.0%
meshkull	3	180	183
%	1.6%	98.4%	100.0%
totali	10	351	361
%	2.8%	97.2%	100.0%
			100.0%

Në lidhje me pensionin mujor që kanë deklaruar të anketuarit, rezultojn që pensioni mesatar që marrin gratë në vlerën 10,335 lekë është më i vogël se pensioni mesatar i burrave që rezultojn në vlerën 12,948. Diferencimi në vlerën e pensionit sipas gjinisë tregon se gratë kanë patur një punë shumë më pak të paguar se burrat dhe ky diferencim në të ardhura bën që target grupi i grave të jetë më i prekur nga varfëria dhe nga fenomene të tjera si dhuna, neglizhenca, abuzimi etj.

Gjinia	Numri i personave	Shuma e pensioneve	Pensioni mesatar
Meshkull	183	2,369,450	12,948
Femret	178	1,839,680	10,335
Total	361	4,209,130	11,66

Të anketuarit nga zonat urbane janë kryesisht punëtorë në masën 27.8% të totalit, por ata punojnë gjithashtu si arkëtarë në masën 16.7%, kuzhinierë dhe ekonomistë në 11.1%, si dhe dentistë, mjekë, bujq, dado për fëmijë, instruktorë e mekanikë në të masë më të vogël. Të anketuarit nga zonat rurale janë më shumë të punësuar si bujq në masën 55.6%, si punëtorë 22.2%, si dhe në përqindje më të vogla blegtorë dhe mësues në masën 11.1% secili.

Tab. 3. Nëse punoni, cili është pozicioni i punës sipas zonave

Profesioni/zona	urbane	rurale	shuma	% urbane	% rurale
arkëtar	3		3	16.7%	0.0%
kuzhinier	2		2	11.1%	0.0%
dentist	1		1	5.6%	0.0%
ekonomist	2		2	11.1%	0.0%
mjek	1		1	5.6%	0.0%
punëtor	5	2	7	27.8%	22.2%
bujk	1	5	6	5.6%	55.6%
blegtor	0	1	1	0.0%	11.1%
dado për fëmijë	1		1	5.6%	0.0%
instruktor	1		1	5.6%	0.0%
mësues	0	1	1	0.0%	11.1%
mekanik	1		1	5.6%	0.0%
totali	18	9	27	100.0%	100.0%

Profesionet më të përhapura në radhët e të intervistuarave femra janë ato të bujqit, punëtorit, secila kategori e përfaqësuar me 38.5%, të ndjekur nga kategoritë e kuzhinier, ekonomist dhe dado secila me 7.7%. Të anketuarit meshkuj punojnë më shumë si arkëtarë me 21.4% dhe punëtorë 14.3%, të ndjekur nga kategoritë e tjera në masë të barabartë prej 7.1% si kuzhinierë, dentistë, ekonomistë, mjekë, bujq, blegtorë, instruktorë, mësues dhe mekanikë. Kategoria e femrave vihet re se është më shumë e punësuar në profesionet që nuk kanë nevojë për nivele të larta shkollimi (punëtorë, bujq), kjo duke vërtetuar akoma më shumë konkluzionet e mëtejshme dhe nga raporte të tjera, ku femrat janë më të diskriminuara në tregun e punës dhe më pak aktive për të ngjitur shkallët e karrierës.

Tab. 4. Nëse punoni, cili është pozicioni i punës sipas gjinisë

profesioni/gjinia	femër	maskull	shuma	femër %	maskull %
arkëtar	1	3	3	0,0%	21,4%
kuzhinier	1	1	2	7,7%	7,1%
dentist	1	1	1	0,0%	7,1%
ekonomist	1	1	2	7,7%	7,1%
mjek	1	1	1	0,0%	7,1%
punëtor	5	2	7	38,5%	14,3%
bujk	5	1	6	38,5%	7,1%
blegtor	1	1	1	0,0%	7,1%
dado për fëmijë	1	1	1	7,7%	0,0%
instruktor	1	1	1	0,0%	7,1%
mësues	1	1	1	0,0%	7,1%
mekanik	1	1	1	0,0%	7,1%
totali	13	14	27	100,0%	100,0%

Mosha e daljes në pension, në bazë të ligjit të sigurimeve shoqërore, është 65 vjeç për burrat dhe 60 vjeç për gratë. Megjithatë ekziston mundësia që, nëse ke derdhur në degen e Sigurimeve Shoqërore përqindje kontributi të barabartë me 35 vjet sigurim dhe ke një vjetërsi në punë të caktuar, mund të përfitosh dalje në pension para moshës së përcaktuar më lart.

Duke analizuar rezultatet e pyetësorit lidhur me moshën e të intervistuarve, vërehet se ata kanë një moshë më të madhe se 55 vjeç dhe ata mund të jenë kryesisht të ndikuar nga ligji i vjetër, i cili lejonte daljen në pension edhe para moshës 60-65vjeç. Këto të dhëna vërtetohen dhe nga rezultatet e studimit ku pjesa kryesore e të anketuarve (38,2%) kanë dalë në pension në moshën 54-55 vjeç dhe 37,7% e tyre në moshën 56-60 vjeç, duke pasur dhe kategoritë e moshave 46-50vjeç dhe 61-65vjeç me 10,5% secila kategori.

Dallime kryesore vërehen edhe midis moshave të daljes në pension në zonat urbane dhe rurale. Këto dallime janë të ndikuara nga kategoritë e profesioneve që të anketuarit kanë kryer, siç u paraqit dhe më lart në tabelën e profesioneve të të anketuarve dhe ndarjen e tyre sipas zonave urban/rural. Në zonat rurale të anketuarit punojnë kryesisht si punëtorë, bujq ose blegtorë, profesione të cilat kanë vështirësi më të madhe dhe sipas ligjit kanë të drejtën të kërkojnë dalje në pension në një moshë më të shpejtë.

¹ Moshë e pensionit ka ndryshuar duke filluar nga 1/07/2000, duke u ndryshuar nga moshat e daljes në pension që ishte 60 vjeç për burra dhe 55 për gratë.

Tab. 5. Në çfarë moshe kanë dalë në pension sipas zonave

zona/ grup- mosha	35-40 vjeç	41- 45	46-50	54-55	56-60	61-65	66- 70	pa përgjigje	shuma
urbane	1	1	28	102	88	25	0	5	250
rurale	0	2	10	36	48	13	2	0	111
totali	1	3	38	138	136	38	2	5	361
	0,3%	0,8%	10,5%	38,2%	37,7%	10,5%	0,6%	1,4%	100,0%

Ligji i Sigurimeve Shoqërore paraqet një dallim diskriminimi pozitiv për femrat, i cili favorizuar ato si për sa i përket moshës së daljes në pension (5 vjet më herët se meshkujt), ashtu edhe periudhës së nevojshme që duhet punuar për të përfituar pensionin, e cila në disa raste është më e shkurtrë për femrat se për meshkujt.

Nga pyetësi vërehet se femrat dalin në pension kryesisht në moshat 54-55 vjeç në masën 55,6%, 56-60 vjeç në masën 24,7% dhe 46-50 vjeç në masën 16,9%. Meshkujt, në krahasim me femrat, dalin disi më vonë në pension, ku pjesa më e madhe e tyre ka dalë në moshën 56-60 vjeç me 50,3%, të ndjekur nga kategoria 61-65 vjeç me 20,8% dhe në përqindje më të vogla, në moshë të tjera.

Tab. 6. Në çfarë moshe kanë dalë në pension sipas gjinisë

mosha	35-40 vjeç	41-45	46-50	54-55	56-60	61-65	66-70	pa përgjigje	shuma
femra	1	1	30	99	44	0	0	3	178
meshkuj	0	2	8	39	92	38	2	2	183
totali	1	3	38	138	136	38	2	5	361
	0,3%	0,8%	10,5%	38,2%	37,7%	10,5%	0,6%	1,4%	100,0%

anketuarit janë përgjigjur në masën 80,1% të totalit se të ardhurat e tyre nuk janë të mjaftueshme, duke pasur një përqindje më të madhe të atyre që janë në zonat rurale me 88,3% dhe 76,4% në zonat urbane. Ky konkluzion përputhet dhe me gjetjet nga raportet e tjera, ku vihet re se të ardhurat nga pensioni janë shumë të ulëta për të jetuar dhe varfëria në zonat rurale është më e madhe se në zonat urbane.



tjera të ardhurave shtesë, nuk ka dallime thelbësore midis të anketuarve femra dhe meshkuj.

Tab. 12. Nëse keni të ardhura shtesë, nga i sigurori ato (sipas gjinisë)

Gjinia	nga brenda vendit	nga emigrantë	nga familjet afërmit	nga puna	nga biznesi	nga pasuria e trashëguar	Tjetër, specifik	pa përgjigje	shuma
Femër	58	33	10	10	7	6	1	53	178
	32.6%	18.5%	5.6%	5.6%	3.9%	3.4%	0.6%	29.8%	100.0%
Mashkull	54	46	7	8	5	7	0	56	183
	29.5%	25.1%	3.8%	4.4%	2.7%	3.8%	0.0%	30.6%	100.0%
Totali	112	79	17	18	12	13	1	109	361
	31.0%	21.9%	4.7%	5.0%	3.3%	3.6%	0.3%	30.2%	100.0%

Të ardhurat mujore në lekë sipas 31.6% të të anketuarve janë 10,001-20,000 lekë, të ndjekur nga 28.5% e totalit të të anketuarve që kanë të ardhura 20,001-30,000 lekë dhe 11.9% e të anketuarve kanë të ardhura 30,001-40,000 lekë. Është për t'u theksuar se 4.7% e të anketuarve ka një nivel të ardhurash prej nën 10,000 dhe pjesa tjetër (23.8%) kanë të ardhura mbi 40,000 lekë. Nivelet e varfërisë janë më të mëdha në zonat rurale sesa në zonat urbane. Kjo vërehet edhe në ndryshimet e niveleve të të ardhurave; ku zonat rurale kanë një përqindje shumë të madhe të të ardhurave nën 10,000 lekë (9% për zonat rurale dhe 2.8% për zonat urbane); niveli i të ardhurave midis 10,001-20,000 lekë (37.8% për zonat rurale dhe 28.8% për zonat urbane); si dhe nivele më të ulta të të ardhurave në kategoritë e tjera të të ardhurave mbi 20,001 lekë.

Tab. 13. Sa janë të ardhurat tuaja mujore në lekë (sipas zonave)

zona	Nën 10000	10001-20000	20001-30000	30001-40000	40001-50000	50001-60000
urbane	7	72	77	31	26	15
	2.8%	28.8%	30.8%	12.4%	10.4%	6.0%
rurale	10	42	26	12	7	3
	9.0%	37.8%	23.4%	10.8%	6.3%	2.7%
totali	17	114	103	43	33	18
	4.7%	31.6%	28.5%	11.9%	9.1%	5.0%

50001-70000	70001-80000	80001-90000	90001-100000	100001-150000	shuma
6	4	4	2	6	250
2.4%	1.6%	1.6%	0.8%	2.4%	100.0%
6	3	0	1	1	111
5.4%	2.7%	0.0%	0.9%	0.9%	100.0%
12	7	4	3	7	361
3.3%	1.9%	1.1%	0.8%	1.9%	100.0%

Statistikat femra deklarojnë se i kanë të ardhurat e tyre mujore më të larta se meshkujt në kategoritë e të ardhurave deri në 40,000 lekë, 60,001-70,000 lekë dhe 70,001-80,000 lekë, ndërsa të anketuarit meshkuj i kanë të ardhurat e tyre mujore më të ulëta se femrat në kategoritë e të ardhurave 40,001-60,000 lekë, 70,001-80,000 lekë dhe mbi 100,001 lekë.

Sa janë të ardhurat tuaja mujore në lekë (sipas gjinisë)

Nën 10000	10001-20000	20001-30000	30001-40000	40001-50000	50001-60000
12	57	51	24	12	6
6.70%	32.00%	28.70%	13.50%	6.70%	3.40%
5	57	52	19	21	12
2.70%	31.10%	28.40%	10.40%	11.50%	6.60%
17	114	103	43	33	18
4.70%	31.60%	28.50%	11.90%	9.10%	5.00%

60001-70000	70001-80000	80001-90000	90001-100000	100001-150000	shuma
7	3	2	2	2	178
3.90%	1.70%	1.10%	1.10%	1.10%	100.00%
5	4	2	1	5	183
2.70%	2.20%	1.10%	0.50%	2.70%	100.00%
12	7	4	3	7	361
3.30%	1.90%	1.10%	0.80%	1.90%	100.00%

Statistikat e studimit tregojnë se të anketuarit me të ardhura deri në 10,000 lekë përfundimisht se ata harxhojnë më shumë për ushqim (71.7%), krahasuar me të ardhurat më të ardhura në kategori të tjera dhe kjo tendencë është më e theksuar në zonat urbane, ku shpenzohet më shumë për ushqim, se sa në zonat rurale për



të anketuarit që kanë të ardhura deri në 10,000 lekë. Kjo ndodh për faktin se ky shpenzim është më i rëndësishmi dhe më i domosdoshmi, sidomos për kategorinë e të ardhurave të cilët kanë të ardhurat më të ulta.

Tab. 15. Të ardhurat tuaja për çfarë i shpenzoni (ushqim)

zona	pa						shuma	
	1	2	3	4	5	6		përgjigje
urbane	181	11	3	8	11	34	2	250
	72.4%	4.4%	1.2%	3.2%	4.4%	13.6%	0.8%	100.0%
rurale	78	5	2	5	3	18	0	111
	70.3%	4.5%	1.8%	4.5%	2.7%	16.2%	0.0%	100.0%
totali	259	16	5	13	14	52	2	361
	71.7%	4.4%	1.4%	3.6%	3.9%	14.4%	0.6%	100.0%

Shpenzimet për veshmbathje janë një shpenzim që haset më shumë tek të anketuarit që kanë të ardhura midis 30,001 deri 50,000 lekë. Shpenzimet për këtë qëllim janë kryesisht të shpërndara në mënyrë të barabartë për të anketuarit me të ardhura të ndryshme në zonat urbane më të mëdha se 10,001 lekë. Për të anketuarit nga zonat rurale, shpenzimet për veshmbathje janë të konsiderueshme sidomos për kategoritë e të ardhurave midis 10,001 deri në 50,000 lekë dhe është më i ulët në kategoritë e tjera.

Tab. 16. Të ardhurat tuaja për çfarë i shpenzoni (veshmbathje)

zona	pa						shuma	
	1	2	3	4	5	6		përgjigje
urbane	19	32	40	41	46	39	33	250
	7.6%	12.8%	16.0%	16.4%	18.4%	15.6%	13.2%	100.0%
rurale	13	28	26	10	18	10	6	111
	11.7%	25.2%	23.4%	9.0%	16.2%	9.0%	5.4%	100.0%
totali	32	60	66	51	64	49	39	361
	8.9%	16.6%	18.3%	14.1%	17.7%	13.6%	10.8%	100.0%

Shpenzimet për ilaçe përbëjnë një zë të rëndësishëm të buxhetit familjar për këto kategori moshash dhe haset më shumë tek të anketuarit që kanë të ardhura midis 10,001 deri 50,000 lekë. Shpenzimet për këtë qëllim janë më të ulta për të anketuarit nga zonat rurale krahasuar me ata të zonave urbane me të ardhura të ulta deri në 10,000 lekë dhe janë më të mëdha për kategoritë e të ardhurave midis 10,001 lekë deri 70,000 lekë dhe ulen për kategoritë e të ardhurave mbi 70,000 lekë.

Tab. 17. Të ardhurat tuaja për çfarë i shpenzoni (ilace)

zona	pa						shuma	
	1	2	3	4	5	6		përgjigje
urbane	20	96	62	25	14	15	18	250
	8.0%	38.4%	24.8%	10.0%	5.6%	6.0%	7.2%	100.0%
rurale	8	47	28	12	5	2	9	111
	7.2%	42.3%	25.2%	10.8%	4.5%	1.8%	8.1%	100.0%
totali	28	143	90	37	19	17	27	361
	7.8%	39.6%	24.9%	10.2%	5.3%	4.7%	7.5%	100.0%

Shpenzimet për argëtim ose turizëm janë shpenzime të kategorisë jo të domosdoshme dhe vhet re që ky shpenzim haset kryesisht tek të anketuarit me të ardhura mbi 90,000 lekë. Por përgjindja kryesore që haset është regjistruar tek anketuarit nga kategoria e të ardhurave deri në 10,000 lekë. Të anketuarit e kategorive të të ardhurave të tjera midis 10,001 deri 90,000 lekë harxhojnë më pak se 10%.

Tab. 17. Të ardhurat tuaja për çfarë i shpenzoni (argëtim/turizëm)

zona	pa						shuma	
	1	2	3	4	5	6		përgjigje
urbane	29	10	11	18	8	26	148	250
	11.6%	4.0%	4.4%	7.2%	3.2%	10.4%	59.2%	100.0%
rurale	19	6	6	10	5	10	55	111
	17.1%	5.4%	5.4%	9.0%	4.5%	9.0%	49.5%	100.0%
totali	48	16	17	28	13	36	203	361
	13.3%	4.4%	4.7%	7.8%	3.6%	10.0%	56.2%	100.0%

Shpenzimet për kafë/pije hasen kryesisht tek të anketuarit që kanë të ardhura midis 10,001 deri 90,000 lekë, kryesisht më shumë për kategorinë e të ardhurave 50,001 deri 70,000 lekë dhe më pak për kategoritë e tjera. Shpenzimet për këtë qëllim janë më të mëdha për të anketuarit nga zonat urbane krahasuar me ata të zonave rurale me të ardhura të ulta deri në 10,000 lekë dhe janë më të ulta për kategoritë e të ardhurave midis 10,001 lekë deri 70,000 lekë dhe ngrihen për kategoritë e të ardhurave mbi 70,000 lekë.



Tab. 18. Të ardhurat tuaja për çfarë i shpenzoni (katë/pjije)

zona	1	2	3	4	5	6	pa përgjigje	shuma
urbane	23	33	29	51	44	17	53	250
	9.2%	13.2%	11.6%	20.4%	17.6%	6.8%	21.2%	100.0%
rurale	10	17	20	32	13	9	10	111
	9.0%	15.3%	18.0%	28.8%	11.7%	8.1%	9.0%	100.0%
totali	33	50	49	83	57	26	63	361
	9.1%	13.9%	13.6%	23.0%	15.8%	7.2%	17.5%	100.0%

Shpenzimet për drita, taksa dhe ujë përbëjnë një zë të rëndësishëm të buxhetit familjar për këto kategori moshash dhe haset më shumë tek të anketuarit që kanë të ardhura midis 10,001 deri 50,000 lekë, sidomos për kategorinë e të ardhurave midis 30,001-50,000 lekë. Shpenzimet për këtë qëllim janë më mëdha për të anketuarit nga zonat urbane krahasuar me ata të zonave rurale me të ardhura të ulta deri në 50,000 lekë dhe janë më të ulta për kategoritë e të ardhurave mbi 50,000 lekë.

Tab. 19. Të ardhurat tuaja për çfarë i shpenzoni (drita, taksa, ujë)

zona	1	2	3	4	5	6	pa përgjigje	shuma
urbane	8	66	91	44	13	13	15	250
	3.2%	26.4%	36.4%	17.6%	5.2%	5.2%	6.0%	100.0%
rurale	2	25	28	21	18	12	5	111
	1.8%	22.5%	25.2%	18.9%	16.2%	10.8%	4.5%	100.0%
totali	10	91	119	65	31	25	20	361
	2.8%	25.2%	33.0%	18.0%	8.6%	6.9%	5.5%	100.0%

Shpenzimet për pajisje dhe orendi shtëpiake janë kryesisht të larta për të anketuarit me të ardhura shumë të ulta deri në 10,000 lekë dhe për ata me të ardhura shumë të larta mbi 70,001 lekë. Kjo tendencë është më e theksuar në zonat rurale se sa në zonat urbane.

Tab. 20. Të ardhurat tuaja për çfarë i shpenzoni (pajisje dhe orendi shtëpiake)

zona	1	2	3	4	5	6	pa përgjigje	Shuma
urbane	26	18	13	16	25	40	112	250
	10.4%	7.2%	5.2%	6.4%	10.0%	16.0%	44.8%	100.0%
rurale	19	7	8	3	12	22	40	111

	17.1%	6.3%	7.2%	2.7%	10.8%	19.8%	36.0%	100.0%
	45	25	21	19	37	62	152	361
	12.5%	6.9%	5.8%	5.3%	10.2%	17.2%	42.1%	100.0%

Shpenzimet me vitin e kaluar, pjesa më e madhe (46.5%) e të anketuarve ndjehen si një pjesë e konsiderueshme 42.4% ndjehen më keq, ndërsa vetëm 11.1% si më mirë. Për sa i përket ndarjeve të përgjigjeve midis të intervistuarve nga zonat urbane dhe ato rurale, nuk vihet re ndonjë ndryshim i theksuar i tendencës përveç faktit se të anketuarit nga qyteti ndihen dyfish më mirë si përqindje të zonat urbane, 6.3% në zonat rurale) se ata të zonave rurale krahasuar me ato urbane.

Tab. 21. Krahasuar me vitin e kaluar ju ndjeheni (sipas zonave)

	më keq	njëlloj	më mirë	Shuma
	105	112	33	250
	42.0%	44.8%	13.2%	100.0%
	48	56	7	111
	43.2%	50.5%	6.3%	100.0%
totali	153	168	40	361
	42.4%	46.5%	11.1%	100.0%

Shpenzimet femra deklarohen në masë më të madhe se meshkujt se, krahasuar me kaluar, ndjehen më keq, ndërsa meshkujt deklarojnë se ata ndjehen njëlloj me kaluar krahasuar me një vit më parë.

Tab. 22. Krahasuar me vitin e kaluar ju ndjeheni (sipas gjinisë)

	më keq	njëlloj	më mirë	Shuma
	78	81	19	178
	43.8%	45.5%	10.7%	100.0%
	75	87	21	183
	41.0%	47.5%	18.9%	107.4%
totali	153	168	40	361
	42.4%	46.5%	11.1%	100.0%

Shpenzimet mesatare mujore në lekë sipas të anketuarve janë në pjesën më të madhe të mesatare mujore në lekë sipas të anketuarve nga 23% e totalit të intervistuarve, të cilët kanë shpenzime midis 30,001-50,000 lekë, por 9.4% kanë shpenzime më të mëdha se niveli 50,001 lekë. Shpenzimet mesatare mujore janë më të mëdha në zonat urbane, krahasuar me ato rurale, ku vihet re sidomos një



përqindje më e madhe (11.2% e të anketuarve) në zonat urbane krahasuar me 5.4% të zonave rurale, kanë shpenzime më të mëdha se niveli 50,001 lekë. Duke ju referuar shpenzimeve mesatare mujore të familjes, 60.7% e të anketuarve kanë shpenzime mesatare ndërmjet 10,000 – 30,000 lekë dhe ky është një tregues tjetër që këta persona në shpenzimet e tyre mbështeten jo vetëm në pensionin mujor, por në të ardhura suplementare, që i sigurojnë nga burime të tjera si: fëmijët, pasuritë që mund të kenë trashëguar, punësimi, biznesi etj.

Tab. 23. Shpenzimet mesatare mujore të familjes tuaj (sipas zonave)

zona	deri në 10000	në 10001-30000	30001-50000	50001-70000	70001-90000	90000-100000	mbi 100000	pa përgjigje	shuma
urbane	11	151	60	13	10	3	2	250	
	4.4%	60.4%	24.0%	5.2%	4.0%	1.2%	0.8%	98.0%	
rurale	14	68	23	5	1	0	0	111	
	12.6%	61.3%	20.7%	4.5%	0.9%	0.0%	0.0%	100.0%	
totali	25	219	83	18	11	3	2	361	
	6.9%	60.7%	23.0%	5.0%	3.0%	0.8%	0.6%	100.0%	

Të anketuarat femra deklarojnë se i kanë të ardhurat e tyre mujore më të larta se ata meshkuj në kategoritë e të ardhurave nën 10,000 lekë, dhe 30,001-90,000 lekë, ndërsa të anketuarit meshkuj i kanë të ardhurat e tyre mujore më të larta se ato femra në kategoritë e të ardhurave 10,001-30,000 lekë, dhe mbi 90,000 lekë.

Tab. 24. Shpenzimet mesatare mujore të familjes tuaj (sipas gjinisë)

gjinia	deri në 10000	në 10001-30000	30001-50000	50001-70000	70001-90000	90000-100000	mbi 100000	pa përgjigje	shuma
femër	13	101	43	11	7	1	2	178	
	7.3%	56.7%	24.2%	6.2%	3.9%	0.6%	1.1%	98.3%	
maskull	12	117	40	8	4	2	0	183	
	6.6%	63.9%	21.9%	4.4%	2.2%	1.1%	0.0%	100.0%	
totali	25	218	83	19	11	3	2	361	
	6.9%	60.4%	23.0%	5.3%	3.0%	0.8%	0.6%	100.0%	

Rezultatet e studimit tregojnë se shpenzimet mesatare mujore për ushqime janë më të larta për të anketuarit me të ardhura deri në 30,000 lekë dhe janë përgjigjur se ata harxhojnë më shumë për ushqim (90.6%) krahasuar me të anketuarit me shpenzime mesatare mujore të tjera.

[36]

Tab. 25. Shpenzimet mesatare mujore të familjes për ushqime

zona	deri në 10000	në 10001-30000	30001-50000	50001-70000	70001-90000	90000-100000	mbi 100000	pa përgjigje	shuma
urbane	82	145	17	3	1	0	2	250	
	32.8%	58.0%	6.8%	1.2%	0.4%	0.0%	0.8%	99.2%	
rurale	55	45	10	1	0	0	0	111	
	49.5%	40.5%	9.0%	0.9%	0.0%	0.0%	0.0%	100.0%	
totali	137	190	27	4	1	0	2	361	
	38.0%	52.6%	7.5%	1.1%	0.3%	0.0%	0.6%	100.0%	

Shpenzimet mesatare mujore për bukë janë më të larta për të anketuarit me të ardhura deri në 40,000 lekë dhe më të ulta për kategoritë me shpenzime mesatare mbi 40,000 lekë. Shpenzimet mesatare mujore për bukë janë më të ulta në zonat urbane për kategorinë deri në 20,000 lekë dhe më të larta për kategoritë mbi 20,000 lekë, krahasuar me ato rurale.

Tab. 26. Shpenzimet mesatare mujore të familjes për bukë

zona	deri në 2000	në 2001-4000	4001-6000	6001-8000	8000-10000	mbi 10000	pa përgjigje	shuma
urbane	116	80	36	4	4	10	250	
	46.4%	32.0%	14.4%	1.6%	1.6%	4.0%	96.0%	
rurale	57	31	11	4	1	7	111	
	51.4%	27.9%	9.9%	3.6%	0.9%	6.3%	100.0%	
totali	173	111	47	8	5	17	361	
	47.9%	30.7%	13.0%	2.2%	1.4%	4.7%	100.0%	

Të anketuarit përgjigjen se 45.7% e tyre nuk organizojnë aspak kohën e tyre ditore për punë, megjithatë 16.1% e tyre e organizojnë pak kohën për punë, 10.0% organizojnë mesatarisht dhe vetëm 9.2% organizojnë shumë kohën e tyre për punë.

Tab. 31. Si është organizuar koha juaj ditore për punë

zona	aspak	pak	mesatarisht	shumë	gjithë kohën	pa përgjigje	shuma
urbane	110	41	23	25	6	45	250
	44.0%	16.4%	9.2%	10.0%	2.4%	18.0%	89.6%
rurale	55	17	13	8	2	16	111

[37]



	49.5%	15.3%	11.7%	7.2%	1.8%	14.4%	100.0%
totali	165	58	36	33	8	61	361
	45.7%	16.1%	10.0%	9.1%	2.2%	16.9%	100.0%

Të anketuarit përgjigjen se 38.2% e tyre nuk e organizojnë aspak kohën e tyre ditore për kujdesin ndaj fëmijëve dhe personave të tjerë në ngarkim, megjithatë 21.1% e tyre e organizojnë pak kohën, 17.7% e organizojnë mesatarisht kohën dhe vetëm 7.8% e organizojnë shumë ose gjithë kohën e tyre e kalojnë duke u kujdesur për fëmijët dhe personat e tjerë në ngarkim. Të anketuarit nga zonat rurale kanë pak a shumë gati të njëjtat karakteristika me ata nga zonat urbane, për sa i përket harxhimit të kohës ditore lidhur me kujdesin për fëmijët dhe persona të tjerë në ngarkim.

Tab. 32. Si është organizuar koha juaj ditore për kujdes për fëmijët dhe persona të tjerë në ngarkim

zona	aspak	pak	mesatarisht	shumë	gjithë kohën	pa përgjigje	shuma
urbane	92	54	42	19	5	38	250
	36.8%	21.6%	16.8%	7.6%	7.6%	15.2%	90.4%
rurale	46	22	22	9	2	10	111
	41.4%	19.8%	19.8%	8.1%	1.8%	9.0%	100.0%
totali	138	76	64	28	7	48	361
	38.2%	21.1%	17.7%	7.8%	1.9%	13.3%	100.0%

Në se do t'i referohemi të dhënave të të anketuarve sipas gjinisë, 11.2% e femrave janë shumë të angazhuara me kujdesin ndaj fëmijëve dhe personave të tjerë të familjes kundrejt 4.4% të burrave.

Tab. 32/1

gjinia	aspak	pak	mesatarisht	shumë	gjithë kohën	pa përgjigje	shuma
femra	56	36	33	20	5	28	178
	31.5%	20.2%	18.5%	11.2%	2.8%	15.7%	100.0%
meshkuj	82	40	31	8	2	20	183
	44.8%	21.9%	16.9%	4.4%	1.1%	10.9%	100.0%
totali	138	76	64	28	7	48	361
	38.2%	21.1%	17.7%	7.8%	1.9%	13.3%	100.0%

Një pjesë të konsiderueshme të kohës së të anketuarve e zë kujdesi për mbarëvajtjen e punëve të shtëpisë, duke pasur parasysh se 49.3% e të anketuarve janë femra. Duke i referuar të dhënave të mëposhtme, vërehet se 66.1% e femrave në zonën urbane dhe 68.4% e femrave në zonën rurale përgjigjen se mesatarisht, shumë dhe gjithë kohën organizojnë kohën ditore për mbarëvajtjen e punëve të shtëpisë. 45.7% e meshkujve në zonën urbane dhe 37% të meshkujve në zonën rurale nuk e organizojnë aspak kohën e tyre për këtë qëllim.

Edhe nga të dhënat e këtij vrojtimi vërejmë ndarjen e pabarabartë të përgjegjësiwe familjare, të cilat rëndojnë më shumë mbi gratë dhe, në rastin konkret, mbi gratë e moshuara, të cilat pjesën më të madhe të kohës e kalojnë me mbarëvajtjen e punëve të shtëpisë, duke krijuar mundësi të pakta për përfshirjen e tyre në komunitet ose në aktivitete të tjera çlodhëse, argëtuese etj. Ndarja e pabarabartë e përgjegjësiwe familjare çon në krijimin dhe fuqizimin e stereotipeve gjinore.

Tab. 33. Si është organizuar koha juaj ditore për mbarëvajtjen e punëve të shtëpisë

zona	aspak	pak	mesatarisht	shumë	gjithë kohën	pa përgjigje	shuma
zona urbane							
femra	11,6%	9,1%	30,6%	25,6%	9,9%	13,2%	100,0%
meshkuj	45,7%	17,1%	14,0%	6,2%	1,6%	15,5%	100,0%
zona rurale							
femra	17,5%	5,3%	33,3%	26,3%	8,8%	8,8%	100,0%
meshkuj	37,0%	27,8%	22,2%	9,3%	0,0%	3,7%	100,0%
totali	103	51	86	59	19	43	361

27.7% e të anketuarve deklarojnë se ata e organizojnë kohën e tyre mesatarisht për bërjen e shpenzimeve të zakonshme të familjes, të ndjekur nga 22.2% e totalit që organizojnë pak kohën e tyre, 18% që nuk e organizojnë kohën e tyre, si dhe një përqindje e konsiderueshme prej 16.6% e totalit që e organizojnë shumë kohën e tyre për bërjen e shpenzimeve të zakonshme të familjes. Të anketuarit nga zonat rurale përgjigjen se 41.4% e tyre e organizojnë aspak ose pak kohën e tyre, krahasuar me 39.6% të zonave urbane, 30.6% e organizojnë mesatarisht krahasuar me 26.4% të zonave urbane, si dhe një përqindje më e madhe prej 23.4% nga zonat rurale, krahasuar me 22% në zonat urbane, e organizojnë shumë ose gjithë kohën për bërjen e shpenzimeve të zakonshme të familjes.



Tab. 34. Si është organizuar koha juaj ditore për bërjen e shpenzimeve të zakonshme në familjes

zona	aspak	pak	mesatarisht	shume	gjithë kohën	shuma
urbane	16.8%	22.8%	26.4%	16.4%	16.4%	98.8%
rurale	20.7%	20.7%	30.6%	17.1%	6.3%	100.0%
femra	26.4%	27.0%	24.7%	10.7%	4.5%	100.0%
meshku	9.8%	17.5%	30.6%	22.4%	7.1%	100.0%
totali	65	80	100	60	21	361
	18.0%	22.2%	27.7%	16.6%	5.8%	100.0%

Breth 40% e të anketuarve e harxhojnë mesatarisht kohën e tyre ditore duke lexuar gazetat dhe duke parë televizor dhe kjo përqindje është më e madhe në zonat rurale, krahasuar me zonat urbane. Megjithatë, ekziston një përqindje prej 29.4% të të anketuarve që harxhojnë pak ose aspak kohë për TV dhe gazetat, përqindje e cila është më e madhe se e atyre (25.4%) që harxhojnë shumë ose gjithë kohën dhe kjo dukuri është më e theksuar në zonat urbane se në zonat rurale. 17.7% e meshkujve harxhojnë shumë dhe gjithë kohën për TV dhe gazetata kundrejt 8.3% e femrave. Duke iu referuar zonës rurale, 45.6% e femrave harxhojnë aspak ose pak kohë me TV ose gazetata kundrejt 13.1% e meshkujve. Në zonën urbane 32% e femrave nuk shikojnë aspak ose pak TV ose lexojnë gazeta kundrejt 25.6% e meshkujve. Diferencimi në përdorimin e kohës së lirë për TV dhe gazetat vihet re jo vetëm ndërmjet femrave dhe meshkujve në të 2 zonat, por vihet re edhe ndërmjet brendaj një gjinie, por sipas zonave. 45.6% e femrave në zonën rurale harxhojnë aspak ose pak kohë për TV dhe gazetata kundrejt 33% të femrave në zonën urbane. Kjo tregon për kohën e pakët të lirë që kanë gratë në zonën rurale, kundrejt grave në zonën urbane, pasqyrë më të angazhuara me punët e shtëpisë dhe me aktivitetet bujqësore. Nga vrojtimi rezultoi se koha që kanë gratë në dispozicion për të parë televizor apo për aktivitetet të tjera si: lexim gazetash apo literaturë artistike, është shumë e pakët kundrejt kohës që kanë në dispozicion meshkujt dhe kjo lidhet me angazhimin e tyre në mbartëvajtjen e shtëpisë, në kujdesin për persona të tjerë të familjes etj.

Tab. 35. Si është organizuar koha juaj ditore për TV dhe gazetat

zona	aspak	Pak	mesatarisht	shumë	gjithë kohën	pa shuma
Zona urbane						
femra	9	31	43	17	6	121
	7.4%	25.6%	35.5%	14.0%	5.0%	100.0%

meshkuj	4	29	46	34	7	9	129
	3.1%	22.5%	35.7%	26.4%	5.4%	7.0%	100.0%
totali	13	60	89	51	13	24	250
Zona rurale							
femra	6	20	23	7	0	1	57
	10.5%	35.1%	40.4%	12.3%	0.0%	1.8%	100.0%
meshkuj	3	4	24	14	7	2	54
	5.6%	7.4%	44.4%	25.9%	13.0%	3.7%	100.0%
totali	9	24	47	21	7	3	111
Totali	22	84	136	72	20	27	361

Të anketuarit i japin një rëndësi të konsiderueshme organizimit të kohës së tyre për shëtitje dhe argëtim, ku 29.1% prej tyre përgjigjen se e organizojnë mesatarisht kohën e tyre ditore vetëm për këtë qëllim dhe kjo tendencë është më e theksuar në zonat urbane. Megjithatë ka një përqindje të madhe prej 28.5% të të anketuarve që nuk organizojnë aspak ose organizojnë pak kohën e tyre ditore për këtë qëllim. Duke iu referuar sipas gjinisë të të anketuarve, vërehet që 51.1% e femrave e organizojnë aspak ose pak kohën e lirë për shëtitje dhe argëtim kundrejt 26.3% e meshkujve.

Tab. 36. Si është organizuar koha juaj ditore për shëtitje dhe argëtim

zona	aspak	pak	mesatarisht	shumë	gjithë kohën	pa shuma
urbane	11.2%	25.2%	31.2%	16.0%	16.0%	99.6%
rurale	10.8%	32.4%	24.3%	18.0%	7.2%	100.0%
Femra	15.7%	35.4%	23.0%	9.6%	3.4%	100.0%
meshkuj	6.6%	19.7%	35.0%	23.5%	4.9%	100.0%
totali	40	99	105	60	15	42
	11.1%	27.4%	29.1%	16.6%	4.2%	11.6%
						100.0%

Frenkuentimi i qendrave ditore për të moshuarit zë një kohë shumë të vogël për të anketuarit, ku gjithsej 4.5% e tyre organizojnë mesatarisht, shumë ose gjithë kohë për këtë qëllim, kjo për faktin se numri i qendrave ditore për ta është i vogël dhe kushtet e funksionimit të tyre mund të mos jenë në nivelet e kërkuara. Kjo tendencë është gati e barabartë si për zonat rurale, ashtu dhe për ato urbane, gjithashtu edhe sipas gjinisë.

Tab. 37. Si është organizuar koha tuaj ditore për frekuentimin e qendrave ditore për të moshuarit

zona	aspak	pak	mesatarisht	shumë	gjithë kohën	pa përgjigje	shuma
zona urbane							
femra	71,9%	0,8%	0,8%	0,0%	0,8%	25,6%	100,0%
meshkuj	66,7%	2,3%	3,1%	1,6%	0,8%	25,6%	100,0%
zona rurale							
femra	66,7%	1,8%	1,8%	3,5%	0,0%	26,3%	100,0%
meshkuj	72,2%	0,0%	3,7%	3,7%	0,0%	20,4%	100,0%
totali	69,2	1,4	2,2	1,6	0,6	25	100

Ndërmarrja e veprimeve vullnetare ka pësuar një rënie të konsiderueshme në Shqipëri nga të gjitha moshat, kjo për faktin se ndryshimi i regjimit mbas viteve 1990 bëri që shoqëria shqiptare të orientohej drejt aktiviteteve që i sillnin të ardhurat duke humbur një nga karakteristikat kryesore që i dallonte shqiptarët më përpara. Kjo tendencë vërehet edhe në gjetjet e pyetësorit tonë, ku përqindja e atyre që merren me veprimtari vullnetare është 3,6, duke pasur një tendencë të njëjtojtë si në zonat rurale, ashtu dhe në ato urbane dhe gjithashtu sipas gjinisë.

Tab. 38. Si është organizuar koha tuaj ditore për veprimtari vullnetare

zona/ gjinia	aspak	pak	mesatarisht	shumë	gjithë kohën	pa përgjigje	shuma
urbane	66,4%	5,2%	1,6%	1,2%	1,2%	24,8%	75,6%
rurale	64,9%	1,8%	1,8%	0,9%	0,9%	29,7%	100,0%
femra	66,3%	4,5%	1,1%	1,1%	1,1%	25,8%	100,0%
meshkuj	65,6%	3,8%	2,2%	1,1%	0,5%	26,8%	100,0%
totali	238	15	6	4	3	95	361
	65,9%	4,2%	1,7%	1,1%	0,8%	26,3%	100,0%

Të anketuarit deklarojnë se kanë dijeni se ekzistojnë institucione të përkujdesit për personat e moshuar në masën 30,2%, por 37,4% e tyre nuk kanë dijeni dhe 32,4% deklarojnë se nuk ka qendra të tilla. Vihet re një mosinformim i të anketuarve në zonat rurale lidhur me institucionet e përkujdesit. 54,1% e të anketuarve nga zonat rurale deklarojnë se nuk dinë gjë lidhur me ekzistencën e këtyre institucioneve krahasuar me 30% të atyre në zonat urbane, vetëm 11,7% e të anketuarve nga zonat rurale pohojnë se ekzistojnë, të cilët janë shumë më pak se ata nga zonat urbane (38,4%).

Tab. 40. A ka në rrethin tuaj institucione të përkujdesit për personat e moshuar (sipas zonave)

zona	po	jo	nuk e di	shuma
urbane	96	79	75	250
	38,4%	31,6%	30,0%	100%
rurale	13	38	60	111
	11,7%	34,2%	54,1%	100%
totali	109	117	135	361
	30,2%	32,4%	37,4%	100,0%

Të anketuarat femra deklarojnë në masë më të madhe (30,9%) se meshkujt (29,5%) se ato kanë dijeni se ekzistojnë institucione të përkujdesit për personat e moshuar, ndërsa të anketuarit meshkuj deklarojnë në masë më të madhe se ata nuk kanë dijeni ose nuk dinë gjë.

Tab. 41. A ka në rrethin tuaj institucione të përkujdesit për personat e moshuar (sipas gjinisë)

Gjinia	po	jo	nuk e di	shuma
femër	55	54	69	178
	30,9%	30,3%	38,8%	100%
meshkull	54	63	66	183
	29,5%	34,4%	36,1%	100,0%
totali	109	117	135	361
	30,2%	32,4%	37,4%	100,0%

Institucionet e përkujdesit për personat e moshuar nuk janë të mjaftueshme sipas të anketuarve, 30,3% e tyre e kanë pohuar këtë konkluzion, i cili është më i theksuar në zonat rurale (53,8% krahasuar me 27,1% në zonat urbane), pasi dhe mungesa e tyre është më e madhe në zonat rurale.

Tab. 42. A janë të mjaftueshme duke iu referuar nevojave të moshës tuaj (sipas zonave)

zona	Po	Jo	Pa përgjigje	Shuma
urbane	9	26	61	96
	9,4%	27,1%	63,5%	100,0%
rurale	6	7	0	13
	46,2%	53,8%	0,0%	100,0%
totali	15	33	61	109
	13,8%	30,3%	56,0%	100,0%



Të anketuarit meshkuj deklarojnë në masë më të madhe se femrat se institucionet e përkujdesit për personat e moshuar nuk janë të mjaftueshme.

Tab. 43. A janë të mjaftueshme duke iu referuar nevojave të moshës tuaj (sipas gjinisë)

Gjinia	Po	Jo	Pa përgjigje	Shuma
femer	10	24	144	178
	5.6%	13.5%	80.9%	100.0%
meshkull	13	22	148	183
	7.1%	12.0%	133.3%	152.5%
totali	23	46	292	361
	6.4%	12.7%	80.9%	100.0%

Nevoja për institucionet e kujdesit për personat e moshuar është më e madhe midis moshave 55-70 vjeç, sidomos midis 55-60 vjeç, pasi janë të anketuarit që i përkasin këtyre kategori moshash, të cilët deklarojnë se institucionet ekzistuese nuk janë të mjaftueshme dhe nevojitet më shumë përkujdesje për personat e moshuar.

Tab. 44. A janë të mjaftueshme duke iu referuar nevojave të moshës tuaj (sipas moshës)

mosha	Jo	Po	Pa përgjigje	Shuma
55-60	2	7	5	14
61-65	4	6	15	25
66-70	2	8	14	24
71-75	2	6	15	23
76-80	2	4	8	14
81-85	1	0	2	3
86-90	1	2	2	5
mbi 90 vjeç	1	0	0	1
Totali	15	33	61	109
	13.80%	30.30%	56.00%	100.00%

B. TË DHËNA SHËNDETËSORE

Vihet re se shumica e të anketuarve vuajnë nga ndonjë sëmundje në masën 83.7%, një tendencë më e theksuar në zonat rurale me 85.6% krahasuar me 82.8% në zonat urbane, fakti i cili, pavarësisht moshës së të anketuarve, ka nevojë për një vëmendje

më të madhe nga institucionet e përkujdesit shëndetësor dhe kjo lidhet edhe me faktin e infrastrukturës shëndetësore në zonat rurale: numri i pakët i qendrave shëndetësore, mungesë e personelit shëndetësor, mungesë e kualifikimeve profesionale në drejtim të trajtimit të problemeve shëndetësore të personave të moshuar dhe cilësia e shërbimeve.

Tab. 44. A vuani nga ndonjë sëmundje (sipas zonave)

zona	Jo	Po	Shuma
urbane	43	207	250
	17.2%	82.8%	100.0%
rurale	16	95	111
	14.4%	85.6%	100.0%
totali	59	302	361
	16.3%	83.7%	100.0%

Kategoria e moshës më të prekur nga sëmundjet është midis 66-70 vjeç, e ndjekur nga kategoria e moshës 61-65 vjeç.

Tab. 45. A vuani nga ndonjë sëmundje (sipas moshës)

mosha	Jo	Po	Shuma
55-60	15	22	37
61-65	21	53	74
66-70	9	74	83
71-75	6	59	65
76-80	4	56	60
81-85	4	22	26
86-90	13	0	13
mbi 90 vjeç	3	0	3
Totali	75	286	361
	20.80%	79.20%	100.00%

Të anketuarit janë përgjigjur se shumica e tyre (51.3%) vuajnë nga më shumë se një sëmundje, por është për t'u theksuar fakti se, të anketuarit e zonave rurale janë në përqindje më të vogël për sa i përket vuajtjes nga më shumë se një sëmundje. Kjo mund të lidhet me mosvajtjen rregullisht në qendrat shëndetësore për t'u ekzaminuar, me largësinë e tyre nga qendrat e barnimit, me kushtet klimatike të favorshme të zonës ku jetojnë, me ushqimet më natyrale që përdorin, me të ardhurat e pakta që disponojnë, me aksesin e ulët të informacionit etj.



Tab. 46. Nëse vuani, nga sa sëmundje vuani (sipas zonave)

zona	1 sëmundje	më shumë se 1 sëmundje	Shuma	Shuma
urbane	97	110	207	68.50%
	46.9%	53.1%	100.0%	
rurale	50	45	95	31.50%
	52.6%	47.4%	100.0%	
totali	147	155	302	100.0%
	48.7%	51.3%	100.0%	100.0%

Në përgjithësi, më shumë se gjysma e të anketuarve vuan nga më shumë se një sëmundje, por vihet re se numri i të anketuarve mbi moshën 70 vjeç është më i madh për sa i përket vuajtjeve nga më shumë se një sëmundje, krahasuar me ata që vuajnë nga një sëmundje për të njëjtën kategori moshe.

Tab. 46. Nëse vuani, nga sa sëmundje vuani (sipas moshës)

mosha	1 sëmundje	më shumë se 1 sëmundje	Shuma
55-60	10	12	22
61-65	30	23	53
66-70	49	25	74
71-75	20	39	59
76-80	21	35	56
81-85	8	14	22
86-90	6	7	13
mbi 90 vjeç	3	0	3
Totali	147	155	302
	48.70%	51.30%	100.00%

Të anketuarit vuajnë në masën 58.6% nga një sëmundje kronike, por 41.4% e tyre vuan nga më shumë se një sëmundje kronike. Tendenca është gati identike si për të anketuarit e zonave urbane, ashtu edhe për ata të zonave rurale.

Tab. 47. Nëse vuani, nga sa sëmundje kronike vuani (sipas zonës)

zona	1 sëmundje	më shumë se 1 sëmundje	Shuma
urbane	121	86	207
	58.5%	41.5%	100.0%
rurale	56	39	95
	58.9%	41.1%	100.0%
totali	177	125	302
	58.6%	41.4%	100.0%

Me rritjen e moshës së të anketuarve, vihet re se ata vuajnë nga më shumë se një sëmundje kronike, kjo sidomos është e theksuar për të anketuarit mbi moshën 71 vjeç, ku vihet re se një përqindje më e madhe e të anketuarve në këtë kategori moshe vuajnë nga më shumë se një sëmundje.

Tab. 47. Nëse vuani, nga sa sëmundje kronike vuani (sipas moshës)

mosha	1 sëmundje	më shumë se 1 sëmundje	Shuma
55-60	14	8	22
61-65	33	20	53
66-70	53	21	74
71-75	28	31	59
76-80	31	25	56
81-85	8	14	22
86-90	7	6	13
mbi 90 vjeç	3	0	3
Totali	177	125	302
	58.60%	41.40%	100.00%

Të anketuarit mendojnë se është e nevojshme asistenca e personave të tjerë në masën 36.0% dhe pjesërisht në masën 20.8%, por 43.2% e tyre mendojnë se asistenca nuk është e nevojshme. Kjo asistencë është gjithmonë e më e nevojshme për të anketuarit që janë pjesë e kategorive 76 vjeç e sipër.



Tab. 48. A ndajeni nevojën e asistencës nga persona të tjerë (sipas moshës)

mosha	Jo	Po	pjesërisht	shuma
55-60	26	7	4	37
61-65	44	11	19	74
66-70	39	31	13	83
71-75	26	19	20	65
76-80	15	32	13	60
81-85	4	20	2	26
86-90	1	9	3	13
mbi 90 vjeç	1	1	1	3
Totali	156	130	23.2	361
	43.2	36	20.8	100.00%

Pjesa më e madhe e të anketuarve (81.2%) deklarojnë se ata bëjnë shëtitje në ajër të pastër dhe kjo tendencë është e barabartë si në zonat urbane, po ashtu dhe në zonat rurale.

Tab. 49. A bëni shëtitje në ajër të pastër (sipas zonave)

zona	po	jo	shuma
urban	203	47	250
	81.2%	18.8%	100.0%
rural	90	21	111
	81.1%	18.9%	100.0%
totali	293	68	361
	81.2%	18.8%	100.0%

Nga përgjigjet e vrojtit, vihet re se meshkujt preferojnë më shumë të bëjnë shëtitje në ajër të pastër në masën 89.1% krahasuar me 73% që deklarojnë femrat, kjo pasi femrat mund të kenë më pak kohë të lirë, pasi ato janë të kushëzuara të merren me punët e shtëpisë ose me kujdesin për personat e tjerë të familjes.

Tab. 50. A bëni shëtitje në ajër të pastër (sipas gjinisë)

gjinia	po	jo	shuma
femër	130	48	178
	73.0%	27.0%	100.0%

mashkull	163	20	183
	89.1%	10.9%	100.0%
totali	293	68	361
	81.2%	18.8%	100.0%

Shëtitja në ajër të pastër është e preferuar nga shumica e të intervistuarve, sidomos për moshat e reja 55-65 vjeç dhe, përqindja e atyre që nuk bëjnë shëtitje në ajër të pastër shkon në rritje, kjo për faktin se me rritjen e moshës, lëvizjet bëhen më të kufizuara.

Tab. 51. A bëni shëtitje në ajër të pastër (sipas moshës)

mosha	Po	Jo	Jo/Po në %	Shuma
55-60	31	6	19.4	37
61-65	63	11	17.5	74
66-70	67	16	23.9	83
71-75	55	10	18.2	65
76-80	50	10	20	60
81-85	17	9	52.9	26
86-90	8	5	62.5	13
mbi 90 vjeç	2	1	50	3
Totali	293	68	23.2	361
	81.2	18.8		100.00%

Shumica e të intervistuarve (75.9%) nuk vizitohen pa shkak tek mjeku i familjes, megjithatë ata deklarojnë se vizitohen një herë në vit në masën 6.1%, dy herë në vit në masën 5% dhe më shumë se dy herë në vit në masën 13%. Nuk vihet re ndonjë ndryshim midis tendencës të përgjigjeve të anketuarve nga zonat urbane dhe ata nga zonat rurale, duke qenë afërsisht e njëjtë me totalin.

Tab. 52. Sa shpesh vizitoheni pa shkak tek mjeku juaj i familjes (sipas zonës)

zona	nuk vizitohem pa shkak	1 herë në vit	2 herë në vit	më shumë se 2 herë në vit	shuma
urbane	190	12	15	33	250
	76.0%	4.8%	6.0%	13.2%	100.0%



rurale	84	10	3	14	111
	75.7%	9.0%	2.7%	12.6%	100.0%
totali	274	22	18	47	361
	75.9%	6.1%	5.0%	13.0%	100.0%

Në përgjithësi të anketuarit nuk vizitohen pa shkak tek mjeku i familjes, por kjo përqindje është më e theksuar në moshat sidomos mbi 81 vjeç.

Tab. 53. Sa shpesh vizitoheni pa shkak tek mjeku juaj i familjes (sipas moshës)

mosha	nuk vizitohen pa shkak	1 herë ne vit	2 herë ne vit	Më shumë se 2 here	shuma	nuk vizitohem/ total
55-60	28	2	4	3	37	75.7
61-65	55	2	4	13	74	74.3
66-70	58	8	6	11	83	69.9
71-75	50	3	2	10	65	76.9
76-80	46	6	2	6	60	76.7
81-85	24	1	0	1	26	92.3
86-90	11	0	0	2	13	84.6
mbi 90	2	0	0	1	3	66.7
Totali	274	22	18	47	361	75.9
	75.9%	6.1%	5.0%	13.0%	100.0%	75.9%

Femrat, ashtu si edhe meshkujt, nuk vizitohen pa shkak në një përqindje përfaqësuese të barabartë, por vihet re një përqindje disi më e lartë tek meshkujt të cilët vizitohen më shumë se femrat në kategorinë e vizitave më shumë se dy herë në vit tek mjeku i familjes.

Tab. 54. Sa shpesh vizitoheni pa shkak tek mjeku juaj i familjes (sipas gjinisë)

zona	nuk vizitohen pa shkak	1 herë në vit	2 herë në vit	më shumë se 2 herë në vit	shuma
urbane	138	11	9	20	178
	77.5%	6.2%	5.1%	11.2%	100.0%

rurale	136	11	9	27	183
	74.3%	6.0%	4.9%	14.8%	100.0%
totali	274	22	18	47	361
	75.9%	6.1%	5.0%	13.0%	100.0%

Të anketuarit shprehin një tendencë mesatare për sa i përket vlerësimit të shërbimit shëndetësor në poliklinika, ku 44.6% e tyre janë shprehur se nuk janë as të pakënaqur, as të kënaqur, por vihet re se kjo tendencë është më e theksuar në zonat rurale (59.5) se në zonat rurale (38%). Megjithatë, duke analizuar në total përgjigjet, del se të anketuarit janë shumë të pakënaqur dhe të pakënaqur në masën 28.8% krahasuar me 26.5% që deklarohen si të kënaqur ose shumë të kënaqur nga shërbimi shëndetësor në poliklinika. Kjo tendencë nuk është njësoj si në zonat urbane dhe ato rurale, pasi në zonat urbane janë në masën 32.8% shumë të kënaqur ose të kënaqur, krahasuar me 12.6% që janë në zonat rurale. Ky dallim vjen për faktin se cilësia e shërbimit në poliklinika është më i mirë në zonat urbane se sa në zonat rurale.

Tab. 55. Sa të kënaqur jeni nga shërbimi shëndetësor në poliklinika (sipas zonave)

zona	shumë i pakënaqur	i pakënaqur	si kënaqur	shumë i kënaqur	shuma
urbane	20	53	95	72	250
	8.0%	21.2%	38.0%	28.8%	100.0%
rurale	11	20	66	13	111
	9.9%	18.0%	59.5%	11.7%	100.0%
totali	31	73	161	85	351
	8.6%	20.2%	44.6%	23.5%	100.0%

Tendencë e ngjashme vihet re nga përgjigjet e të anketuarve lidhur me vlerësimin e shërbimit shëndetësor në spitale, ku mbizotëron një vlerësim mesatar i tij me 44.3% të totalit të përgjigjeve dhe gati e njëjtë si për ata nga zonat rurale, po ashtu dhe për ata nga zonat urbane. Duke analizuar totalin e përgjigjeve, përsëri të intervistuarit kanë deklaruar se janë shumë të pakënaqur dhe të pakënaqur në masën 36% krahasuar me 19.7% që deklarohen si të kënaqur ose shumë të kënaqur nga shërbimi shëndetësor në poliklinika. Kjo tendencë nuk është njësoj si në zonat urbane dhe ato rurale, pasi në zonat urbane janë në masën 22.8% shumë të kënaqur ose të kënaqur, krahasuar me 12.6% që janë në zonat rurale.

Tab. 56. Sa të kënaqur jeni nga shërbimi shëndetësor në spitale (sipas zonave)

zona	shumë i pakënaqur	asi i pakënaqur	asi i kënaqur	shumë i kënaqur	shuma	
urbane	31	51	111	54	3	250
	12.4%	20.4%	44.4%	21.6%	1.2%	100.0%
rurale	16	32	49	13	1	111
	14.4%	28.8%	44.1%	11.7%	0.9%	100.0%
totali	47	83	160	67	4	361
	13.0%	23.0%	44.3%	18.6%	1.1%	100.0%

Të anketuarit nuk kanë një vlerësim pozitiv mbi skemën e rimbursimit të ilaçeve: 69.5% e tyre shprehen si shumë të pakënaqur ose të kënaqur nga ajo. Megjithatë ekziston një përqindje prej 30.5% që kanë një vlerësim mesatar ose të kënaqshëm, prapë ngelet shumë për t'u bërë lidhur me përmirësimin e kësaj skeme. Me gjithë ndryshimet e bëra, ka vite që kjo skemë has në kundërshtime dhe debate të ndryshme. Duke krahasuar përgjigjet e të anketuarve nga zonat rurale dhe ato urbane, vihet re një tendencë shumë e ngjashme me totalin e përgjigjeve.

Tab. 57. Sa të kënaqur jeni nga skema e rimbursimeve të ilaçeve (sipas zonave)

Zona	shumë i pakënaqur	asi i pakënaqur	asi i kënaqur	shumë i kënaqur	shuma	
urbane	85	89	50	23	3	250
	34.0%	35.6%	20.0%	9.2%	1.2%	100.0%
rurale	45	32	25	8	1	111
	40.5%	28.8%	22.5%	7.2%	0.9%	100.0%
totali	130	121	75	31	4	361
	36.0%	33.5%	20.8%	8.6%	1.1%	100.0%

C. ANGAZHIME NË KOMUNITET

Të anketuarit deklarojnë një masë të konsiderueshme prej 81.4%, se nuk përfshihen në procese vendimmarrëse apo konsultative në bashki/komunë apo në zonën e tyre kurse vetëm 18.6% e tyre shprehen se janë përfshirë dhe kjo shtron nevojën e

rritjes së iniciativave të përfshirjes së kësaj moshe në proceset vendimmarrëse në komunitet. Tendenca e përfshirjes është më e lartë në zonat rurale, krahasuar me ato urbane. Kjo lidhet edhe me mentalitetin që ka qenë mbizotërues në këto zona në lidhje me rolin vendimmarrës të burrave ose të pleqve brenda familjes së madhe dhe në komunitet.

Tab. 58. A jeni përfshirë në procese vendimmarrëse apo konsultative në bashkinë/komunën/zonën tuaj (sipas zonave)

zona	po	jo	shuma
urbane	44	206	250
	17.6%	82.4%	100.0%
rurale	23	88	111
	20.7%	79.3%	100.0%
totali	67	294	361
	18.6%	81.4%	100.0%

Të anketuarat femra deklarojnë në përqindje më të madhe se meshkujt se ato nuk janë të përfshira në procese vendimmarrëse apo konsultative në bashkinë/komunën/zonën e tyre. Kjo lidhet me ndarjen e pabarabartë të përgjegjësiwe familjare, që rëndojnë më shumë mbi gratë, duke përfshirë edhe ato të moshës së tretë, që janë më të angazhuara se burrat në mbarëvajtjen e punëve të shtëpisë apo në kujdesin për persona të tjerë të familjes si nipër, mbesa apo bashkëshort.

Tab. 59. A jeni përfshirë në procese vendimmarrëse apo konsultative në bashkinë/komunën/zonën tuaj (sipas gjinisë)

Gjinia	po	jo	shuma
Femër	27	151	178
	15.20%	84.80%	100.00%
Mashkull	40	143	183
	21.90%	78.10%	100.00%
Totali	67	294	361
	18.60%	81.40%	100.00%

Megjithatë të anketuarit nuk janë përfshirë në procese vendimmarrëse apo konsultative në bashki/komunë apo në zonën e tyre, ata mendojnë se janë të aftë për të kontribuar në shoqëri, duke renditur familjen si kategorinë kryesore me 70.1%, e ndjekur nga angazhimi me punë në masën 11.9%, organizata dhe shoqata joqeveritare në masën 11.6%, dhe angazhimi në jetën kulturore e shkencore me



5.5%. Të anketuarit nga zonat rurale vlerësojnë më shumë familjen si fushën ku mund të kontribuojnë, se sa të anketuarit nga zonat urbane, pasi familja është më e bashkuar në zonat rurale. Po ashtu, të anketuarit nga zonat rurale e ndjejnë veten të aftë të kontribuojnë në organizata e shoqata joqeveritare, por më pak se ata nga zonat urbane, pasi këto shoqata janë më shumë aktive në zonat urbane.

Tab. 60. Në cilën fushë e ndjeni veten të aftë për të kontribuar në shoqëri (sipas zonave)

zona	në familje	duke punuar	organizata dhe OJF	jetën kulturore, shënësore	tjetër specifiko	shuma
urbane	170	28	34	15	3	250
	68.0%	11.2%	13.6%	6.0%	1.2%	100.0%
rurale	83	15	8	5	0	111
	74.8%	13.5%	7.2%	4.5%	0.0%	100.0%
totali	253	43	42	20	3	361
	70.1%	11.9%	11.6%	5.5%	0.8%	100.0%

Një përqindje e konsiderueshme e të intervistuarve kanë deklaruar se ata kanë punuar edhe mbas daljes në pension (31.9%), por kjo përqindje është më e vogël në zonat urbane (28%) se sa në zonat rurale (40.5%), për vetë faktin se në zonat rurale varfëria është më e madhe dhe është e nevojshme të punohet më shumë edhe mbas daljes në pension.

Tab. 61. Mbas daljes në pension, a keni punuar (sipas zonave)

zona	po	jo	shuma
urbane	70	180	250
	28.0%	72.0%	100.0%
rurale	45	66	111
	40.5%	59.5%	100.0%
totali	115	246	361
	31.9%	68.1%	100.0%

Dalja në pension nuk i ka penguar të intervistuarit që të vazhdojnë të punojnë, megjithatë kjo tendencë është më e theksuar tek meshkujt (37.2%), krahasuar me 26.4% tek femrat dhe kjo lidhet me angazhimin e tyre në punët e shtëpisë.

Tab. 62. Mbas daljes në pension a keni punuar (sipas gjinisë)

gjinia	po	jo	shuma
Femër	47	131	178
	26.4%	73.6%	100.0%
meshkull	68	115	183
	37.2%	62.8%	100.0%
totali	115	246	361
	31.9%	68.1%	100.0%

Të anketuarit në masën 95.6% shprehen se nuk është ushtruar dhunë mbi ta gjatë këtij viti, por ekziston një përqindje prej 4.4% e cila deklaron të kundërtën dhe kjo karakteristikë është pak a shumë e njëjtë si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale.

Tab. 63. Gjatë këtij viti, a jeni dhunuar ndonjëherë (sipas zonave)

zona	jo	rrallë	shpesh	vazhdimisht	shuma
urban	239	7	2	2	250
	95.6%	2.8%	0.8%	0.8%	100.0%
rurale	106	4	1	0	111
	95.5%	3.6%	0.9%	0.0%	100.0%
totali	345	11	3	2	361
	95.6%	3.0%	0.8%	0.6%	100.0%

Pavarësisht gjinisë së të anketuarve, ata paraqesin karakteristikë të njëjta lidhur me faktin nëse është ushtruar dhunë mbi ta gjatë këtij viti, duke ekzistuar vetëm një ndryshim i vogël në përqindjet e të anketuarve femra, të cilat deklarojnë ushtrimin e dhunës së shpeshtë në masën 1.7%, krahasuar me meshkujt që e deklarojnë 0. Megjithatë, fenomeni i dhunës është një fenomen shumë pak i deklaruar, gjë që lidhet me mentalitetin që është shumë më i theksuar për personat e moshuar, lidhet me mundësitë e pakta për mbështetje që ofrohen për viktimat e dhunës (në zonat rurale këto mundësi nuk ekzistojnë) etj.



Tab. 64. Gjatë këtyrë viti, a jeni dhunuar ndonjëherë (sipas gjinisë)

Gjinia	jo	rallë	shpesh	vazhdimisht	shuma
Femër	169	5	3	1	178
	94.9%	2.8%	1.7%	0.6%	100.0%
Mashkull	176	6	0	1	183
	96.2%	3.3%	0.0%	0.5%	100.0%
Totali	345	11	3	2	361
	95.6%	3.0%	0.8%	0.6%	100.0%

Të anketuarit e vlerësojnë mesatarisht shërbimin e punonjësve të sigurimeve shoqërore në masën 48.8%, por 34.4% e tyre e vlerësojnë atë si të kënaqshëm ose shumë të kënaqshëm, pavarësisht faktit se 16.9% janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur. Vlerësimi pozitiv i punonjësve të sigurimeve shoqërore është më i madh nga të anketuarit e zonave urbane me 40.4%, krahasuar me ata të zonave rurale 20.7%.

Tab. 65. Vlerësoni nivelin e kënaqësisë tuaj lidhur me shërbimin e punonjësve të sigurimeve shoqërore (sipas zonave)

zona	shumë i pakënaqur	i pakënaqur	as i pakënaqur as i kënaqur	i kënaqur	shumë i kënaqur	shuma
urbane	16	29	104	93	8	0
	6.4%	11.6%	41.6%	37.2%	3.2%	0.0%
rurale	6	10	72	22	1	111
	5.4%	9.0%	64.9%	19.8%	0.9%	100.0%
totali	22	39	176	115	9	361
	6.1%	10.8%	48.8%	31.9%	2.5%	100.0%

Shërbimi i punonjësve të postave vlerësohet gjithashtu si pozitiv nga të anketuarit ku 34.3% e vlerësojnë mesatarisht dhe 52.1% e tyre deklarohen si të kënaqur ose shumë të kënaqur nga ai. Tendanca e vlerësimit pozitiv është më e theksuar në zonat urbane, pasi dhe ky shërbim është më prezent në këto zona.

Tab. 66. Vlerësoni nivelin e kënaqësisë tuaj lidhur me shërbimin e punonjësve të postave (sipas zonave)

Zona	shumë i pakënaqur	i pakënaqur	as i pakënaqur as i kënaqur	i kënaqur	shumë i kënaqur	shuma
urbane	15	24	67	122	22	250
	6.0%	9.6%	26.8%	48.8%	8.8%	100.0%
rurale	3	7	57	40	4	111
	2.7%	6.3%	51.4%	36.0%	3.6%	100.0%
totali	18	31	124	162	26	361
	5.0%	8.6%	34.3%	44.9%	7.2%	100.0%

Shërbimi i punonjësve socialë është vlerësuar gjithashtu pozitiv nga të anketuarit, ku 57.3% e konsiderojnë atë në nivelin mesatar dhe 27.9% deklarohen si të kënaqur ose shumë të kënaqur nga ai. Nga rezultatet e kësaj pyetje, vihet re se të anketuarit nga zonat urbane janë deklaruar më shumë të pakënaqur ose të pakënaqur në masën 16.4%, krahasuar me 10.8% nga zonat rurale.

Tab. 67. Vlerësoni nivelin e kënaqësisë tuaj lidhur me shërbimin e punonjësve socialë (sipas zonave)

Zona	shumë i pakënaqur	i pakënaqur	as i pakënaqur as i kënaqur	i kënaqur	shumë i kënaqur	shuma
urbane	21	20	125	78	6	250
	8.4%	8.0%	50.0%	31.2%	2.4%	100.0%
rurale	5	7	82	16	1	111
	4.5%	6.3%	73.9%	14.4%	0.9%	100.0%
totali	26	27	207	94	7	361
	7.2%	7.5%	57.3%	26.0%	1.9%	100.0%

1. Pjesëmarrja aktive në shoqëri dhe në zhvillim.

Krijimi i mundësive për personat e moshuar, nëpërmjet politikave specifike që të krijojnë kushte për një pjesëmarrje më aktive të tyre në shoqëri dhe për t'i dhënë mundësi të vazhdojnë të kontribuojnë në zhvillimin e vendit.

Përfshirja e personave të moshuar në proceset vendimmarrëse apo konsultative në bashki dhe komuna, veçanërisht kur miratohet buxheti dhe kur trajtohen probleme specifike që lidhen direkt me këtë target grup.

Ngritja e një strukture për personat e moshuar, e cila do të sigurojë një koordinim më të mirë ndërinstitucional dhe me shoqërinë civile, për të adresuar dhe zgjidhur problemet me të cilat përballen personat e moshës së tretë, duke synuar përmirësimin e mirëqënies së tyre jetike dhe një integrim më të mirë në proceset e zhvillimit të shoqërisë.

2. Punësimi i personave të moshuar.

Rritja e mundësive për punësim për personat e moshuar në zonat rurale, duke stimuluar zhvillimin e aktiviteteve jobujqësore si krijimi i ndërmarrjeve familjare apo bizneseve të vogla me aktivitete që plotësojnë sektorin e bujqësisë si: turizmi, përpunimi dhe zejtaria lokale, agrobiznesi.

Ofrimi i kurseve kualifikuese dhe trajnimeve për moshën e tretë, në mënyrë që të përshpërtohen me teknologjitë e reja.

Rishikimi i skemës së sigurimeve shoqërore në lidhje me masën e përfshirjes së kontributit shtesë të personave të moshuar që kanë dalë në pension në vlerën përfundimtare të pensionit, e cila do të ndikonte në minimizimin e punës informale të këtij grupimi.

Vlerësimi i kontributit dhe përvojës së personave të moshuar dhe përfshirja e tyre në proceset e zhvillimit të shoqërisë dhe, në mënyrë të veçantë, në botën akademike.

3. Forcimi i solidaritetit përmes barazisë dhe reciprocitetit midis brezave.

Rritja e solidaritetit ndërbrezor, nëpërmjet fushatave sensibilizuese dhe planeve të veprimit për promovimin e vlerave të personave në moshën e tretë, duke përfshirë edhe përfaqësues të brezit të ri.

4. Zhvillimi rural, migrimi dhe urbanizimi.

Rritja e kontributit të pushtetit vendor dhe qendror, si dhe e shoqërisë civile në mbështetjen e këtij grupi, duke u angazhuar në ndërmarrjen e programeve të veçanta mbështetëse, që mundësojnë pjesëmarrjen e tyre në procese të ndryshme të zhvillimit komunitar, si edhe në përmirësimin e mëtejshëm të kushteve të jetesës dhe të infrastrukturës, që të arrihet sado pak zbulja e marxhinalizmit të personave të moshuar në zonat rurale.

5. Sigurimi shoqëror, mbrojtja sociale dhe parandalimi i varfërisë.

Përmirësimi i shërbimit në qendrat rezidenciale dhe rritja e numrit të tyre, në mënyrë që të përmushen nevojat për të gjitha grupet në nevojë.

Ofrimi i kurseve kualifikuese dhe trajnimeve për kualifikimin dhe rikualifikimin profesional të aktorëve që veprojnë në fushën e shërbimeve sociale.

Fokus i veçantë në politikat qeveritare duhet të jetë garantimi i një minimumi të mjaftueshëm të ardhurash për të gjithë personat e moshuar, veçanërisht për grupet e pafavorizuara në planin social dhe ekonomik.

6. Akses i barabartë në shërbimet shëndetësore.

Ndërryerjet dhe politikat shëndetësore në të ardhmen duhet të orientohen drejt përmirësimit dhe qëndrueshmërisë së gjendjes shëndetësore dhe stilit të jetesës mes individëve të moshuar, duke parashikuar ndërryerjet shëndetësore në mënyrën e duhur në akses e cilësi.

7. Personat e moshuar dhe paaftësia.

Sigurimi i ndërryerjeve dhe krijimi i mjedisve mbështetëse për të gjithë personat e moshuar, veçanërisht për ata me aftësi të kufizuar, për të nxitur pavarësinë dhe fuqizimin e tyre për të marrë pjesë në të gjitha aspektet e jetës së shoqërisë, si edhe për të ruajtur kapacitetin funksional gjatë gjithë jetës së tyre.

Mbështetja e programeve të ofrimit të shërbimeve në shtëpi për personat e moshuar dhe, në mënyrë të veçantë, fokusuar tek ato me aftësi të kufizuar dhe të vetmuar.

8. Banimi dhe mjedisi i jetesës.

Të sigurohen lehtësira transporti për personat e moshuar në të gjithë territorin e vendit dhe të zgjerohet rrethi i të moshuarve që përfillojnë nga këto lehtësira.

9. Kujdesi dhe mbështetja e personave që ofrojnë mbështetje.

Institucionet qendrore dhe lokale të sigurojnë burimet e nevojshme për kujdesje dhe shërbime të vazhdueshme për personat e moshuar dhe mbështetjen e kujdestarisë. Po ashtu, duhet të mbështeten personat e moshuar, veçanërisht gratë si ofrues shërbimesh.

PYETSOR

PREZANTIMI: Mirëdita, më quajmë _____ dhe jam punonjës në _____. Ne po bëjmë një vrojtim që fokusohet mbi disa çështje në mbështetje të hartimit të strategjisë për mbështetjen e të moshuarve. Ju jeni përzgjedhur rastësisht për të qenë një nga të intervistuarit mbi këtë temë. Ne ruajmë anonimatin e përgjigjeve në këtë vrojtim dhe informacioni është konfidencial. Nuk jeni e/i detyruar të merrni pjesë, nëse nuk dëshironi.

Data e intervistimit ____/08 / 2008
Ora e fillimit të intervistës _____
Ora e mbarimit të intervistës _____

A. TË DHËNA DEMOGRAFIKE DHE EKONOMIKE

- 1- Zona e të intervistuarit? 0=Urbane, 1=Rurale (0), (1) (1)
- 2- Gjinia e të intervistuarit? 0=Femer, 1=Mashkull (0), (1) (2)
- 3- Moshë e të intervistuarit? 1=55-60 2=60-65 vjeç, 3= 66-70, 4=71-75, 5=76-80, 6=81-85, 7=86-90, 8= mbi 90 vjeç (1)(2)(3)(4)(5)(6) (7)(8) (3)
- 4- Statusi i gjendjes civile të të intervistuarit? 1=Beqar/e, 2=I/E martuar, 3=I/E divorcur 4=I/E ve (3)(4) (4) (1) (2)

- 5- Sa fëmijë keni? 1=0, 2=1, 3=2, 4=me shumë fëmijë (1) (2) (3)(4) (5)

- 6- Fëmijët tuaj ndodhen: 0=brenda vendit, 1=jashtë vendit (0) (1) (6)

- 7- Ju jetoni: 0= i/e vetëm, 1=vetëm me bashkëshortin/en, 2=me fëmijët, (0) (1) (2) (3) (4) (7)
3=mbaj asistente 4=Ijetër specifikojë _____

- 8- A ka pjesëtarë të tjerë në familjen tuaj që sigurojnë të ardhura: 0=Jo, 1=Po, (0) (1) (8)

B. TË DHËNA EKONOMIKE DHE SOCIALE

- 9- Vendbanimi: 0=Fshat, 1=Qytet, (Specifiko qytetin/fshatin): _____ (0) (1) (9)

- 10- A merrni pension? 0=Jo, 1=Po (0) (1) (10)

- 11- Nëse po: Viti i daljes në pension _____, vite në pension _____, pensioni mujor _____lekë (11)

- 12- Profesionit që keni patur para daljes në pension: _____ (12)

- 13- Nëse punoni, cili është pozicioni i punës _____ (13)

- 14- Në çfarë moshe keni dalë në pension? _____ vjeç (14)

- 15- A janë të mjaftueshme të ardhurat për jetesën tuaj? 0=po, 1=jo (0) (1) (15)

16- A keni të ardhura të tjera? 0=po, 1=jo

(0) (1) (16)

17- Nëse po, nga i sigurori të ardhurat shtesë? 1= Nga fëmijët brenda vendit

2= Nga fëmijet emigrante 3= Nga të afërmit 4= Nga puna 5= Nga biznesi

6= Nga pasuria e trashëguar 7= Tjetër specifikoje, _____ (17)

(1) (2) (3) (4) (5) (6) (7)

18- Sa janë të ardhurat tuaja mujore gjithsej _____ lekë

(18)

19- Të ardhurat tuaja për çfarë i shpenzoni? Renditni

sipas madhësisë së shpenzimeve: _____ (19)

Ushqim	(1) (2) (3) (4) (5) (6)	(20)
Veshmbathje	(1) (2) (3) (4) (5) (6)	(21)
Ilace	(1) (2) (3) (4) (5) (6)	(22)
Argëtim Turizëm	(1) (2) (3) (4) (5) (6)	(23)
Kafe, pije	(1) (2) (3) (4) (5) (6)	(24)
Drita, ujë, taksa	(1) (2) (3) (4) (5) (6)	(25)
Pajisje dhe orendi shtëpiake	(1) (2) (3) (4) (5) (6)	(26)
Tjetër, specifikoje _____	(1) (2) (3) (4) (5) (6)	(27)

20- Sa vite keni punuar para daljes në pension? _____ vite të plota

(28)

21- Statusi i punësimit? 0= papunë, 1= në punë

(1) (29)

22- Krahasuar me vitin e kaluar, ekonomikisht ju ndjeheni:

(1) (2) (30)

0=më keq, 1= njëlloj, 2=më mirë

23- Shpenzimet mesatare mujore të familjes tuaj në lekë _____

(31)

Nga këto:

Për ushqime	lekë	(32)
Nga këto per bukë	lekë	(33)
Për veshmbathje	lekë	(34)
Për pajisje dhe orendi shtëpiake	lekë	(35)
Shpenzime shëndetësore	lekë	(36)
Shpenzime për energji elektrike, ujë e taksa të ndryshme	lekë	(37)
Shpenzime të tjera _____	lekë	(38)

24- Konsumi mesatar mujor i familjes tuaj për disa produkte:

(39)

Bukë	kilogram	(40)
Mish dhe nënproduktet të tij	kilogram	(41)
Qumësht dhe nënproduktet të tij	kilogram	(42)
Perime dhe patate	kilogram	(43)
Fruita dhe agrume	kilogram	(44)
Kafe	kilogram	(45)
Tjetër, specifikoje _____	kilogram	(46)

25- Si është organizuar koha juaj ditore? Rendisni sipas sasisë së kohës që zënë

aktivitetet e mëposhtme gjatë një dite: 0=Aspak 1= Pak 2= Mesatarisht 3=

Shumë 4=Gjithë kohën

Punë	(0) (1) (2) (3) (4)	(47)
Kujdes per fëmijët dhe persona të tjerë në ngarkim	(0) (1) (2) (3) (4)	(48)
Mbarëvajtja e punëve të shtëpisë (gatim, pastim etj.)	(0) (1) (2) (3) (4)	(49)
Bëria e shpenzimeve të zakonshme të familjes (pazaret, pagesat e taksave, ujit, energjisë elektrike, telefonit etj.)	(0) (1) (2) (3) (4)	(50)
Televizioni dhe gazetat	(0) (1) (2) (3) (4)	(51)

Shëtitje dhe argëtim	(0) (1) (2) (3) (4)	(52)
Frekentim i qendrave ditore për të moshuarit	(0) (1) (2) (3) (4)	(53)
Veprimtari-vullnetare	(0) (1) (2) (3) (4)	(54)
Tjetër (specifikojë): _____	(0) (1) (2) (3) (4)	(55)

26- A ka në rrethin tuaj institucione (rezidenciale dhe/ose ditore) të përkujdesit për personat e moshuar? 0=Po, 1=Jo 9=nuk e di
(0) (1) (9) (56)

27- A janë të mjaftueshme, duke iu referuar nevojave të moshës tuaj? 0=Po, 1=Jo (0) (1) (57)

28- A kanë tregues të jashtëm cilësorë? 0=po, 1=Jo
(1) (58)

29- Nëse Jo: çfarë do të ishte e nevojshme të ndryshohej, përmirësohej në këto qendra?

1=Shërbimi Shëndetësor që ofrohet 2=Kapaciteti 3=Kualifikimi i stafit
4=Ushqimi 5=Argëtimi
6=Tjetër (specifikojë) _____
(1) (2) (3) (4)
(5) (6) (59)

C. TË DHËNA SHËNDETËSORE

30- A vuani nga ndonjë sëmundje: 0=Jo, 1=Po
(1) (60)

31- Nëse po: nga 0=1 sëmundje, 1= Më shumë se një sëmundje
(1) (61)

32- Nga këto sëmundje kronike: 0=1 sëmundje, 1=më shumë se një sëmundje kronike (0) (1) (62)

33- Sa janë shpenzimet mujore për ilaçe _____ lekë, nga këto disbursohen _____ lekë (63)

34- Si e vlerësoni gjendjen tuaj shëndetësore në karahasim me vitin e kaluar:
0= Më keq, 1=Njësoj, 2=Më mirë, 9=Nuk e di
(3) (9) (64)

35- A ndjeni nevojën e asistencës nga persona të tjerë: 0=Jo, 1=Po, 2=Pjesërisht (0) (1) (2) (65)

36- A jeni përdorues i rregullt i duhanit: 0=Jo, 1=Po, 2=Rrallë
(0) (1) (2) (66)

37- A jeni përdorues i rregullt i alkoolit: 0=Jo, 1=Po, 2=Rrallë
(0) (1) (2) (67)

38- A bëni shëtitje në ajër të pastër? 0=Po 1=Jo
(0) (1) (68)

39- Nëse po, sa herë në javë? 0=Një herë 1=Dy herë 3=Tre herë 4=Çdo ditë (0)
(1) (2) (3) (4) (69)

40- Sa shpesh vizitoheni pa shkak tek mjeku juaj i familjes? 0= Nuk vizitohen pa shkak
1= Një herë në vit 2= Dy herë në vit 3= Më shumë se dy herë në vit
(1) (2) (3) (70)

41- Sa të kënaqur jeni nga shërbimi shëndetësor në institucionet si më poshtë përmendur?

1=Shumë i pakënaqur, 2=l pakënaqur, 3= As i pakënaqur as i kënaqur, 4=l kënaqur, 5=Shumë i kënaqur

(71)				
Nga shërbimi i kujdesit shëndësor në poliklinika	(1) (2) (3) (4) (5)			(72)
Nga shërbimi i kujdesit shëndësor në spitalë	(1) (2) (3) (4) (5)			(73)
Nga skema e rimbursimeve të ilaçeve	(1) (2) (3) (4) (5)			(74)

42- Rendisni konsumin e ushqimeve sipas përmbajtjes:

(75)				
Sheqerore	(1) (2) (3)			(76)
Proteinke	(1) (2) (3)			(77)
Zaravate dhe fruta të freskëta	(1) (2) (3)			(78)

42- Gjendja juaj shëndësore, a kërkon të mbani dietë? 1=Jo 2=Po (1) (2) (79)

43- Nëse po, afërsisht sa lekë shpenzime mujore shtesë kërkon dieta? _____ lekë (80)

44- Nëse po, ju arrini ta zbatoni dietën e kërkuar: 1=Jo 2=Po (2) (81) (1)

D. ANGAZHIME NË KOMUNITET

45- A jeni përfshirë në procese vendimmarrëse apo konsultative në bashkinë /komunën/zonën tuaj? 0=Po, 1=Jo (82)

Nëse Po, a janë marrë parasysh mendimet tuaja? 0=Aspak 1=Pjesërisht (0) (1) (83)

Nëse Jo, arsytet: _____

46. Në cilën fushë e ndjeni veten të aftë për të kontribuar në shoqëri?

1=Në familje 2=Duke punuar 3=Duke u aktivizuar nëpër organizata dhe shoqata

të ndryshme joqeveritare 4=Duke marrë pjesë në jetën kulturore, politike, shkencore etj. 5= Tjetër, specifikoje _____ (1) (2) (3) (4) (5)

(84)

47- Mbas daljes në pension a keni punuar? 0=Po 1=jo (0) (1) (85)

Nëse Po, jepni arsyet duke zgjedhur një nga mundësitë e mëposhtme:

1=Për arsye ekonomike 2=Për t'u ndjerë të dobishëm 3= Ndjen se mund të kontribuosh akoma

4=Tjetër, specifikoje _____ (1)
(2) (3) (4) (86)

Nëse Jo, jepni arsyet: 1= Nuk keni gjetur punë 2= Mbështetje për mbarëvajtje në familje

(punët e shtëpisë, kujdesi për fëmijët, pazaret, etj) 3= Nuk ndjeheni të aftë nga ana shëndësore

4=Nuk ju kanë lejuar anëtarë të tjerë të familjes 5= Nuk keni patur nevojë 6=Tjetër, specifikoje _____ (1) (2) (3)
(4)(5) (6) (87)

48- Me kë jetoni? 1= Vetëm 2= Me fëmijët 3= Me të afërm të tjerë 4=Në shtëpinë e përkuqdesit për personat e moshuar (azil) 5=Tjetër, specifikoje _____ (1) (2) (3) (4)(5) (88)

E. TË NDRYSHME

49- A keni banesë në pronësinë tuaj: 0=Jo, 1=Po (1) (89) (0)

50- A merrni kompensim të energjisë elektrike: 0=Jo, 1=Po 9=Nuk e di (0) (1) (9) (90)

51- A merrni ndonjë lloj ndihme nga bashkia/komuna: 0=Jo, 1=Po 9=Nuk e di (0) (1) (9) (91)

52- A frekuentoni qendra rezidenciale ditore: 0=Jo, 1=Po, 2=Rallë (0) (1) (2) (92)

53- Mesatarisht sa herë në muaj përdorni shërbimin urban: ___ her
ë (93)

54- Gjatë këtij viti, a jeni dhunuar ndonjëherë: 0=Jo, 1= Rrallë, 2=Shpesh,
3=Vazhdimisht (0) (1) (2) (3) (94)

55- Në se përgjigja është 1, 2 dhe/ose 3 specifikoj nga kush _____
(95)

56- Në se përgjigja është 1, 2 dhe/ose 3 specifikoj si _____
(96)

57- Vlerësoni nivelin e kënaqësisë suaj nga aspektet në vijim 1=Shumë i
pakënaqur, 2=I pakënaqur, 3=As i pakënaqur as i kënaqur, 4=I kënaqur, 5=Shumë i
kënaqur (97)

Nga shërbimi i punonjësve të sigurimeve shogjorore	(1) (2) (3) (4) (5)	(98)
Nga shërbimi i punonjësve të postave	(1) (2) (3) (4) (5)	(99)
Nga shërbimi i punonjësve socialë	(1) (2) (3) (4) (5)	(100)

58- Ju lutem, rendisni tre problemet më të rëndësishme që gjykoni se
permirësojnë Jetën tuaj: (101)

1- _____

2- _____

3- _____

Faleminderit!

**(a) Shënime të
MPÇSSH (Kjo pjesë
do të plotësohet në
zyrat e MPÇSSH)**